

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5959  
E premte, 20 dhjetor 2019  
çmimi 0.40 €

## Një marrëdhënie skizofrenike Rusi - Serbi dhe Kosova (2)

Dr. Enver  
HOXHAJ



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SHBA-ja, BRITANIA DHE BE-ja KËRKOJNË KONSTITUIMIN E  
INSTITUCIONEVE TË DALA NGA ZGJEDHJETE 6 TETORIT


# NDËRKOMBËTARËT: TË FORMOHET QEVERIA SHPEJT



Ndërkombëtarët kanë shtuar presionin për formimin e institucioneve të Kosovës. Ambasada e ShBA-së dhe e Britanisë së Madhe, si dhe Zyra e BE-së në Prishtinë, kanë

vlerësuar se nevojitet formim i shpejtë i qeverisë së re për t'i çuar përpara proceset që e presin Kosovën. Të njëjtën gjë kanë kërkuar edhe deputetët gjermanë Peter Beyer dhe

Christian Schmidt, të cilët e kanë vizituar Kosovën dhe kanë i takuar liderët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratik të Kosovës (LDK)



## Murati: Ndryshimet kushtetuese për presidentin, të vështira

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka theksuar të enjten se të gjithë flasin për domosdonë e ndryshimit të Kushtetutës për zgjedhjen

e presidentit, por askush nuk e trajton vështirësinë e ndryshimeve kushtetuese. Ai ka thënë se për ndryshimet kushtetuese, përveç 2/3 e të gjithë

deputetëve, nevojiten edhe 2/3 e deputetëve të pakicave, që nënkupton së paku edhe katër deputetë serbë që vijnë nga Lista Serbe

### OPINION

KOSOVA, NË PRAG TË KRIJIMIT  
TË QEVERISË, PRITSHMËRI TË  
LARTA QYTETARE F. 11

Prof. Lisen  
BASHKURTI



### AKTUALE

PËRURORHEN HAPËSIRAT E  
RINOVUARA NË KLINIKËN E  
BIOKIMISË F. 3

MUNGESA E ORGANIZIMIT DHE  
KOORDINIMIT NË MES TË  
AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE  
E BËN TË PASIGURT TRAFIKUN  
RRUGOR F. 3

POLICIA E KOSOVËS DHE  
AJO E MAQEDONISË REALIZOJNË  
USHTRIM TË PËRBASHKËT  
NDËRKUFITAR F. 5



### EKONOMI

PO JETËSOHET PROJEKTI  
MË I MADH I ENERGJISË SË  
RIPËRTËRITSHME NË KOSOVË F. 9

MATOSHI PREMTON  
ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TË  
NDOTJES SË MJEDISIT NGA  
QESËT E PLASTIKËS F. 9

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijibiznesi.com  
info@kolegijibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# SIGMA



## VIENNA INSURANCE GROUP

**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË**

### NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

*Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,*  
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• **Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës**

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!**

### NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

*Dear clients and interested parties,*  
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• **Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova**

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

**Thank you for your understanding and welcome to the new offices!**

### OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

*Dragi klijenti i zainteresovane strane,*  
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• **Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova**

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

**Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!**



**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net) [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net)

## BE-ja ofron 10 milionë euro grante për Ballkanin Perëndimor

TIRANË, 19 DHJETOR - Komisioni Evropian ofron 10 milionë euro grante për integrimin ekonomik rajonal në Ballkanin Perëndimor. Bashkëpunimin rajonal, BE-ja e sheh si një element vendimtar për prosperitet në Ballkanin Perëndimor dhe një pjesë thelbësore të udhës së anëtarësimit të tij në bllokun evropian. Një rajon që praktikon një fluks të lirë mallrash, shërbimesh, njerëzish dhe kapitali është një rajon që demonstroi përparim drejt BE-së", u tha nga Delegacioni i Bashkimit

Evropian, (BE) në Tiranë. Në këtë kuadër, siç thotë DW, u nënshkruan tri kontrata të reja financuese me Sekretariatit e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Forumin e Investimeve të 6 Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së BP dhe Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit, (GIZ) GmbH. Delegacioni i BE-së në Tiranë bën me dije se "kontratat u nënshkruan në kuadër të javës

së CEFTA-s, të kryesuar nga Shqipëria, të konsideruar nga Genoveva Ruiz Calavera, drejtore për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, si "një moment i rëndësishëm për të vlerësuar përparimin e bërë për rritjen e tregtisë së rajonit". "Kjo javë e CEFTA-s, ka qenë shumë e suksesshme me miratimin e angazhimeve të rëndësishme për të liberalizuar tregtinë në shërbime. Kontratat që nënshkruam sot do të kontribuojnë shumë për t'i kthyer këto marrëveshje në rezultate të



prekshme në dobi të biznesit dhe operatorëve ekonomikë të rajonit", citohet të ketë thënë

Genoveva Ruiz Calavera, drejtore për BP, në Komisionin Evropian.

## Amerikanët insistuan që Kosova të ishte e pranishme në mini shengenin ballkanik

Samiti i nesërm që do të mbahet në Durrës, do të jetë nën mbikëqyrjen amerikane, të cilët e shohin me shqetësim refuzimin e deritanishëm të Prishtinës për t'u bërë pjesë e nismës dhe ata u kanë kërkuar me insistim autoriteteve të Kosovës përfshirjen në këtë nismë

TIRANË, 19 DHJETOR - Ndryshe nga dy samitet e mëparshme të mbajtura në Nish dhe Ohër, ai i Tiranës për shengenin ballkanik, që do të mbahet nesër (e shtunë) do të jetë nën mbikëqyrjen amerikane. Një burim diplomatik i tha "Top Channel" se në këtë takim të radhës, Departamenti amerikan i Shtetit do t'i dërgojë dy përfaqësues të posaçëm për t'i ndjekur nga afër punimet e samitit. Shtetet e Bashkuara përmes të dërguarit special për Ballkanin, Mathew Palmer, e kanë mbështetur qysh në fillim nismën e përbashkët rajonale të Shqipërisë,

Serbisë e Maqedonisë së Veriut. "Top Channel" po ashtu ka mësuar se në samitin e nesërm (e shtunë) do të jetë i pranishëm edhe presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviç. Ndërkaq pala amerikane e sheh me shqetësim refuzimin e deritanishëm të Prishtinës për t'u bërë pjesë e nismës dhe burime të rezervuara diplomatike thanë, se ata u kanë kërkuar me insistim autoriteteve kosovare përfshirjen në këtë nismë. Presidenti Hashim Thaçi ka shpjeguar përmes një postimi në profilin e tij në "Facebook" arsytet



e refuzimit të ftesës së kryeministrit Rama, gjë që sipas tij nuk ka lidhje me marrëdhëniet e shkëlqyera mes Kosovës dhe Shqipërisë, por me faktin se Serbia

nuk e njeh Kosovën. Ndërkohë që Kosova është ende pa qeverinë e dalë nga zgjedhjet e fundit, e në tilla kishte, nuk dihet se cili do të jetë qëndrimi zyrtar i

ekzekutivit të ri të Prishtinës në këtë drejtim.

Tashmë nisma e shengenit ballkanik, mbështetet pa ekuivok jo vetëm nga ShBA-ja por edhe nga BE-ja.

Edhe pse kryeministri Edi Rama deklaroi se në samitin rajonal që do të organizohet në Tiranë, do të jetë edhe shefi i ri i diplomacisë evropiane, Joseph Borrel, por mediet serbe kanë njoftuar se shefi i diplomacisë evropiane nuk do të jete marrë pjesë në takimin e liderëve ballkanikë.

Liderët e vendeve të rajonit pa praninë e udhëheqësve të Kosovës, për herë të parë u takuan në Novi Sad dhe pastaj në Ohër të Maqedonisë së Veriut, ku kanë rënë dakord përmes një deklaratë për synimin e përmirësimit të bashkëpunimit rajonal, apo të krijimit të një "Minishengen ballkanik".

## Slovakia i dorëzon Shqipërisë kryesimin e OSBE-së për vitin 2020



Organization for Security and Co-operation in Europe

TIRANË, 19 DHJETOR -Shqipërisë iu dorëzua të enjten Kryesia e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë për vitin 2020. Misioni shqiptar në Vjenë bën të ditur se, "sot në Këshillin e

Përhershëm të OSBE-së u zhvillua ceremonia e dorëzimit të Kryesisë së kësaj organizate". Kryesia e kësaj organizate iu dorëzua ambasadorit të Shqipërisë pranë Misionit të

OSBE-së dhe Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë, Iglj Hasani. Misioni shqiptar në Vjenë falënderon Kryesinë slovake për përpjekjet e saj dhe thekson se, "jemi në pritje të marrim zyrtar-

isht Kryesinë shqiptare të OSBE-së më 1 janar 2020".

Shqipëria ka marrë Kryesinë e ardhshme të OSBE-së, organizatës së përbërë nga 57 vende anëtare, të cilën ajo do ta drejtojë përgjatë gjithë vitit 2020.

## Zaevi takon komisararin evropian të Zgjerimit, Varhely

SHKUP, 19 DHJETOR - Komisarari evropian i Zgjerimit, Oliver Varhei inkurajon Maqedoninë e Veriut t'i vazhdojë reformat që t'i fillojë negociatat për anëtarësim në BE. Pas takimit me kryeministrin, Zoran Zaevi, në profilin e tij në Twitter, Varhei shkroi: "Inkurajoj Maqedoninë e

Veriut t'i vazhdojë të gjitha reformat e nevojshme në drejtësi dhe në luftën kundër korrupsionit, në mënyrë që të arrijë një vendim pozitiv për fillimin e negociatave me BE-në", shkruan Oliver Varhely. Ndërkaq Zaevi i cili pas takimit me euro-komisarin mori pjesë në

samitin e Iniciativës së Evropës Qendrore (CEI) në Romë, ftoi BE-në të arrijë kompromis për zgjerimin dhe në mars vendit t'i japë dritë jeshile për fillim të negociatave për anëtarësim. "Ideja për metodologji të re të zgjerimit të BE-së është e arsyeshme vetëm nëse procesi

bëhet më efikas, më i besueshëm dhe nëse nxjerr më shumë përfitime për shtetet candidate për anëtarësim në Union. Prandaj, ne apelojmë për konsensus të shpejtë mes shteteve anëtare të BE-së, për parimet dhe elementet e metodologjisë së re, që do të krijojnë mundësi për sjelljen e



vendimit për fillim të negociatave për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut", tha Zoran Zaev.

# Murati: Ndryshimet kushtetuese për presidentin, të vështira



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka thënë se të gjithë flasin për domosdonë e ndryshimit të Kushtetutës për zgjedhjen e presidentit, por askush nuk e trajton vështirësinë e ndryshimeve kushtetuese. "Këto ditë, të gjithë, gazetarët, analistët dhe ekspertët juridikë po e trajtojnë si rrugëdalje nga ngërçet politike për ndërtimin e institucioneve pas zgjedhjeve, ndryshimin e Kushtetutës dhe zgjedhjen e presidentit nga qytetarët. Sigurisht kjo është zgjidhja më e mirë për situatën tonë, pa pasur nevojë për ndryshime shtesë të përgjegjësi-ve të presidentit të vendit, i cili edhe me rregullimin aktual ka mjaft përgjegjësi. Por ajo që më habit është lehtësia me të cilën diskutohet për ndryshimet kushtetuese, thuajse është çështje e konsensusit shoqëror që do të rezultonte në një vullnet politik për ndryshimet e nevojshme kushtetuese. Ky konsensus ekziston, por për ndryshimet kushtetuese, përveç 2/3 e të gjithë deputetëve, nevojiten edhe 2/3 e deputetëve të pakicave, që nënkupton së paku edhe katër deputetë serbë që vijnë nga Lista Serbe", ka thënë Murati, duke shtuar se me këtë mekanizëm shumë të dëmshëm

për funksionalitetin e shtetit të Kosovës, Lista Serbe, rrjedhimisht Beogradi zyrtar, e shfrytëzon në vazhdimësi për ta destabilizuar Kosovën. "Pra, ashtu si në rastin e ushtrisë, Lista Serbe në asnjë variant nuk e jep votën për një ndryshim kushtetues që e bën Kosovën më funksionale. Në anën tjetër, pse do të duhej ata të japin votën e tyre dhe të heqin dorë nga një atu që u jep fuqi politike në Kuvend sa herë që nuk ka konsensus ndërshqiptar (e që, për çështjen e presidentit, gati asnjëherë nuk ka pasur). Me situatën aktuale, dhe nevojën që në dy raundet e para të jenë të pranishëm 80 deputetë, ata çdoherë do të jenë faktorë politikë", ka thënë ai. Andaj, sipas tij, edhe kjo situatë tregon se sa e domosdoshme është që ne si shoqëri të kemi të qartë se dialogun me Serbinë nuk duhet ta shohim vetëm si një obligim në raport me partnerët, por një nevojë jetësore që nga ai ne të dalim si shtet funksional. "E kjo do të nënkuptonte jo vetëm njohje nga Serbia por, mbi të gjitha, mundësi për ndryshime kushtetuese që nuk do të na mbanin peng të zgjedhjeve të përcudnuara kushtetuese që nuk kanë kuptim në situatën kur pakicat, të gjitha së bashku, nuk janë më shumë se 5-7 për qind të popullsisë", ka deklaruar Murati.

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka theksuar të enjten se të gjithë flasin për domosdonë e ndryshimit të Kushtetutës për zgjedhjen e presidentit, por askush nuk e trajton vështirësinë e ndryshimeve kushtetuese. Ai ka thënë se për ndryshimet kushtetuese, përveç 2/3 e të gjithë deputetëve, nevojiten edhe 2/3 e deputetëve të pakicave, që nënkupton së paku edhe katër deputetë serbë që vijnë nga Lista Serbe

## Mungesa e organizimit dhe koordinimit në mes të autoriteteve përgjegjëse e bën të pasigurt trafikun rrugor

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) e ka bërë publik raportin e auditimit të performancës "Siguria në trafikun rrugor". Raporti konkludon se mungesa e zbatimit, organizimit dhe koordinimit të aktiviteteve nga autoritetet përgjegjëse e bën të pasigurt trafikun rrugor për pjesëmarrësit në trafik.

Në këtë raport theksohet se organet përgjegjëse, Policia e Kosovës, e cila duhet ta garantojë zbatimin e rregullave nga pjesëmarrësit në trafik dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, së bashku me komunat, të cilat duhet të sigurojnë rrugë dhe infrastrukturë të sigurt për pjesëmarrësit në trafik, nuk janë efektive dhe nuk po bëjnë sa duhet për të rritur sigurinë në trafik.

Të gjeturat e auditimit nxjerrin në pah se mbulimi i rrugëve me kon-

troll policor në trafikun rrugor në rajonin e Prishtinës është i mangët; kontrollet policore nuk orientohen sipas nevojave apo rreziqeve, si dhe kontrollet nuk inspektohen/mbikëqyren rregullisht nga Divizioni i Komunikacionit Rrugor dhe nga Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor-Prishtinë.

Për më tepër, sistemi informativ i Policisë së Kosovës karakterizohet me të dhëna jo të plota dhe të pasakta rreth analizimit dhe identifikimit të shkaktarëve e të faktorëve të aksidenteve në trafikun rrugor. Gjithashtu, sipas gjetjeve të auditimit, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit (MIT) nuk ka arritur t'i implementojë kriteret e rëndësishme të sigurisë rrugore si dhe nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për identifikimin dhe menaxhimin e vendeve të rrezikshme në rrugë (pikat e zeza).

Pos kësaj, MIT-ja nuk ka krijuar



bazë të të dhënave që do ta mundësonin identifikimin e vendeve të rrezikshme dhe evidentimin/identifikimin e saktë të shkaktarëve dhe faktorëve të aksidenteve. Për më shumë, monitorimi ndaj qendrave për kontrolle teknike të automjeteve nga MIT-ja dhe subjekti i autorizuar për

mbikëqyrje ishte i mangët. Lidhur me të gjeturat e raportit, Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, ka deklaruar se mangësitë e identifikuar në auditim paraqesin shqetësim për nivelin e zbatimit të masave të duhura për përmirësimin e sigurisë në trafik. "Ministria e

Infrastrukturës dhe Transportit, Policia e Kosovës dhe niveli lokal kanë rol kyç në ofrimin e sigurisë në trafikun rrugor për pjesëmarrësit në trafik. Megjithatë, mangësitë e identifikuar në auditim paraqesin shqetësim për nivelin e zbatimit të masave të duhura për përmirësimin e sigurisë në trafikun rrugor", është shprehur Osmani.

Me qëllim të adresimit urgjent të sigurisë në trafikun rrugor në vend, Zyra Kombëtare e Auditimit i rekomandon Qeverisë së Kosovës dhe autoriteteve përgjegjëse që të ndërmarrin hapa konkretë për të ofruar siguri në trafikun rrugor.

Raporti i auditimit të performancës "Siguria në trafikun rrugor" përfshin periudhën e viteve 2016, 2017 dhe 2018. Auditimi kishte për qëllim vlerësimin nëse institucionet publike kanë ndërmarrë veprimet e duhura për të ofruar dhe promovuar siguri në trafikun rrugor në vend.

ShBA-ja, Britania dhe BE-ja kërkojnë konstituimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit

# Ndërkombëtarët kërkojnë të



Ndërkombëtarët kanë shtuar presionin për formimin e institucioneve të Kosovës. Ambasada e ShBA-së dhe e Britanisë së Madhe, si dhe Zyra e BE-së në Prishtinë, kanë vlerësuar se nevojitet formim i shpejtë i qeverisë së re për t'i çuar përpara proceset që e presin Kosovën. Të njëjtën gjë kanë kërkuar edhe deputetët gjermanë Peter Beyer dhe Christian Schmidt, të cilët e kanë vizituar Kosovën dhe kanë takuar liderët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratik të Kosovës (LDK)

cilin e lehtëson BE-ja. "Seanca konstitutive e Kuvendit është caktuar të mbahet më 26 dhjetor. Zgjedhjet e përgjithshme të 6 tetorit i dhanë mundësinë popullit të Kosovës ta ushtrojë të drejtën e vet demokratike për të votuar dhe zgjedhur udhëheqësit e vet. Ky është thelbi i procesit demokratik. Ne besojmë se palët në fjalë do ta arrijnë konsensusin e nevojshëm për t'i tejkaluar sfidat e mbetura",

është thënë në deklaratën e BE-së, duke shtuar se nevojitet formim i shpejtë i qeverisë për t'i çuar proceset përpara.

**Beyer dhe Schmidt: Kjo javë është vendimtare për krijimin e qeverisë**

Deputetët gjermanë Peter Beyer dhe Christian Schmidt, të cilët e kanë vizituar Kosovën, kanë

**EPOKA  
ERE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 19 DHJETOR** - Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (BE) ka kërkuar të enjten konstituimin sa më të shpejtë të institucioneve të Kosovës. Këtë qëndrim e kanë mbështetur edhe Ambasada e ShBA-së dhe ajo e Britanisë së Madhe në Prishtinë, duke thënë se qytetarët e Kosovës presin një qeveri e cila duhet të sjellë ndryshime. "Ne pajtohemi me BE-në: njerëzit e Kosovës janë të padurueshëm për një qeveri që do të sjellë ndryshime pozitive", është thënë në postimin e Ambasadës Amerikane në profilin e saj në

"Facebook". Deklaratën e Zyrës së BE-së në Kosovë e ka mbështetur edhe Ambasada e Britanisë. "Ne e mbështesim deklaratën e përfaqësueses së lartë të BE-së, të EULEX-it dhe krerëve të misionëve të BE-së në Kosovë", është thënë në një reagim të Ambasadës së Britanisë në faqen e saj në "Twitter". Në deklaratën e përfaqësuesve evropianë në Prishtinë është thënë se Kosova duhet urgjentisht ta vazhdojë punën në reforma për zhvillim ekonomik dhe shoqëror, si dhe sundim të ligjit, zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE-Kosovë dhe dialogun me Beogradin të



# formohet qeveria shpejt



Meqë vij nga EPP-ja, ka qenë me rëndësi të vij këtu, edhe me kërkesë të Donald Tuskut. Do ta informojnë edhe Merkelin për zhvillimet sepse ajo është e interesuar çfarë po ndodhë", është shprehur Schmidt.

Kurse deputeti i CDU-së, Peter Beyer, ka deklaruar se duhen negociata të suksesshme. "Të gjithë politikanët e kuptojnë rëndësinë e përgjegjesisë që e kanë pas zgjedhjeve për të themeluar qeveri stabile. Koha po mbaron, prandaj duhen negociata të suksesshme. Nuk duam të ndërhyjmë, se nuk është në mandatin tonë, por kemi ardhur për t'i dëgjuar dhe lënë disa porosi. Negociatat për koalicion nuk duhet të humbin në detaje teknike. Ndiejmë se ka vullnet politik për ta formuar qeverinë për të mirën e qytetarëve. Nëse ka besim të ndërsjellë nuk duhet humbur në detaje teknike. Asnjëri nuk duhet të përipiqet ta dobësojë tjetrin, por të ketë qasje profesionale", ka thënë Beyer.

## Deputetët gjermanë: Nuk është koha të flitet për postin e presidentit

Deputetë gjermanë në adresimin e tyre për media kanë përmendur edhe çështjen e postit të presidentit të cilin po e kërkon LDK-ja dhe që është bërë penge-sa kryesore për arritjen e marrëveshjes për koalicion qeverisës në mes të këtyre dy subjekteve.

Deputeti i CSU-së, Christian Schmidt, ka deklaruar se tani nuk është koha që të diskutohet për këtë çështje. "Tash për tash nuk është koha që të zgjidhet presidenti, por të formohet qeveria", ka thënë Schmidt. Ndaj kësaj ka reaguar edhe deputeti tjetër Peter Beyer, duke e aprovuar qëndrimin e kolegut të tij me fjalën "saktësisht".

Ndaj këtij mesazhi të deputetëve gjermanë ka reaguar deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu. Ajo përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se tani nuk është koha që të zgjedhet presidenti, por që të formohet qeveria. "Mesazhi i qartë: Tash për tash nuk është koha që të zgjidhet presidenti, por të formohet qeveria", ka shkruar Haxhiu.

Dy partitë që kanë fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet e 6 tetorit, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, janë në negociata për formimin e koalicionit qeveritar, por ende nuk kanë arritur ndonjë marrëveshje. Ndërsa seanca konstitutive e Kuvendit të Kosovës është caktuar të mbahet më 26 dhjetor.

## POLICIA E KOSOVËS DHE AJO E MAQEDONISË REALIZOJNË USHTRIM TË PËRBASHKËT NDËRKUFITAR

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar të enjten pikën kufitare në Gllloboqicë, pika kufitare me Maqedoninë e Veriut, për ta parë nga afër ushtrimin e përbashkët të Njësive të Specializuara të forcave të Policisë të Republikës së Kosovës dhe Policisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ushtrim ky i koduar me emrin "Potera-Ndjekja".

Pas përfundimit të ushtrimit të përbashkët operativ-taktik të forcave policore të të dy vendeve, kryeministri në detyrë, Haradinaj, para të pranishmëve të shumtë tha se sot dy porosi vlejnë për të gjithë ne. "E para, Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë besim në njëra-tjetrën, popujt tanë, shtetet tona, politika jonë, institucionet, ekonomia, rendi dhe ligji. Mbi bazën e këtij besimi rendin dhe ligjin do ta bëjmë dhe do ta ruajmë

bashkë, në mënyrë që krimin, kriminelët, rreziqet t'i përballim bashkë", ka thënë kryeministri në detyrë Haradinaj. Ai ka thënë se u gëzohen sukseseve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, suksesit drejt NATO-s, duke potencuar se edhe Kosova i ka aspiratat e saj. Porosia e dytë ka të bëjë me sigurinë, në rast të vendimit të liberalizimit të vizave për Kosovën e që, siç theksoi kryeministri në detyrë, Haradinaj, kjo do të thotë se kufijtë janë të sigurt dhe nuk ka mundësi që kriminelët të lëvizin lirshëm në mes të vendeve tona. "Qytetarët duhet ta kenë të drejtën e lirë, të lëvizin e ta gëzojnë lirinë. Qytetarët e Kosovës edhe në këtë fundvit, edhe për krishtlindje, nuk janë të lirë, nuk mund të udhëtojnë lirshëm në Evropë apo në familjen evropiane", ka thënë Haradinaj. Po ashtu, kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka falënderuar forcat policore të të dy vendeve për profesionalizmin e dëshmuar sot, duke

thënë se ata e bëjnë jetën e sigurt për pronën dhe qytetarët e dyja vendeve. Nga një fjalë në këtë ceremoni mbajtën edhe ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Ekrem Mustafa, zëvendëskryeministri dhe ministër i Punëve të Brendshme të Maqedonisë së Veriut, Oliver Spasovski, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj dhe drejtori i Policisë së Maqedonisë së Veriut, Sasho Tashevski. Me këtë rast është nënshkruar protokollin i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për çështjet që ndërlidhen me sigurinë dhe ngjarjet e mëdha publike, protokoll bashkëpunimi ndërmjet dy ministrive për trafikun hekurudhor. Në fund të ceremonisë u ndanë mirënjohje dhe letër falënderime për njësitë pjesëmarrëse në këtë operacion.



qenë më të drejtpërdrejtë ndaj partive fituese. Pasi kanë takuar liderin e LV-së, Albin Kurti dhe atë të LDK-së, Isa Mustafa, kanë mbajtur një konferencë për medie, ku kanë kërkuar prej këtyre dy partive formimin sa më të shpejtë të qeverisë së re.

Deputeti i CSU-së, Christian Schmidt, ka deklaruar se kjo javë është vendimtare për krijimin e qeverisë. Ai i ka ftuar zyrtarët e LV-së dhe të LDK-së që të flasin drejtpërdrejt mes vete e jo nëpërmjet mediave. "Për koalicion ekziston një rregull i artë që juve mund t'ju dëshpërojë si gazetarë. Në qoftë se bisedimet për koalicion janë në vazhdim e sipër, rregulla është telefoni, jo mikrofoni. Nuk duhet folur derisa ta shohim tymin e bardhë", ka thënë Schmidt, duke shtuar se ish-kancelari gjerman Helmut Kohl i ka mësuar që në politikë të ketë mirëbesim dhe përgjegjësi.

Ai ka deklaruar se për gjendjen aktuale do ta informojnë edhe kancelaren Merkel. "Për ne është jashtëzakonisht në interes ta bëjmë të qartë se zhvillimi i Kosovës dhe perspektiva evropiane e Kosovës janë me rëndësi.

# Një marrëdhënie skizofrenike Rusi - Serbi dhe Kosova (2)

Gjatë vizitës në Beograd, presidenti rus, Putin, përveç takimeve me homologët serbë, përshëndetjes ushtarake nga artileria serbe dhe vizitës në Katedralen Shën Sava, pati pritje mirëseardhjeje nga rreth 100 000 qytetarë. Putini nuk pritet askund në Evropë. Vizita në Serbi do t'i shërbejë një lloj triumfi diplomatik, por nuk ishte ceremoniale në karakterin e saj. Më e rëndësishme është se çfarë ndodhi në margjina të vizitës që, në fakt, ishte edhe qëllim i saj.



Dr. Enver HOXHAI

Kur ministri i Jashtëm rus Sergej Lavrov vizitoi Beogradin në shkurt të vitit 2018, përveç temave të tjera, ai tha se BE-ja po synon ta vendosë Ballkanin në "një lojë" sikurse bëri me Ukrainën. Sipas tij, BE-ja po ofron një zgjedhje të vetme në tavolinë: ose të jesh me Perëndimin ose me Rusinë. Për Lavrov, ky ishte burimi i konfliktit në Ukrainë, jo ndërhyrja direkte ushtarake ruse për katër vjet me radhë. Kjo tregon edhe se si Moskë luan dhe operon me kartat që i ka në Evropën Lindore. Por edhe sa i takon Evropës Jug-lindore, në Moskë mendohet se si, varësisht nga rrethanat, të përdoren një apo disa shtete të Ballkanit si një "kalë Troje" për interesat e saj. Është në interesin rus që rajoni të mbetet në status quo, të bëhet një zonë periferike evropiane, duke degraduar zhvillimet pozitive drejt humnerës. Fragmentarizimi i rajonit dhe minimi i interesave perëndimore ndodh me qëllim të kultivimit të rivalitetit ndaj zgjerimit euroatlantik. Përderisa në lindje qasja ruse në pesë vjetët e fundit duket e suksesshme, dilema është se si mund të duket rajoni ynë në vitet që pasojnë.

Ndër qëllimet politike është edhe degradimi demokracisë liberale si model politik. Rusia preferon një forcim të autoritarizmit si sistem rus. Kjo do të shpinte edhe në një konkurrencë të sistemeve politike deri tek rivaliteti gjeopolitik me Perëndimin në plan të gjerë. Kjo do të ndryshonte parimet dhe vlerat e kulturës politike në Ballkan me ambicien drejt përafrimit të një modeli euro-aziatik politik. Kështu, përveç bashkëpunimit me qeveritë të ndryshme, një vëmendje i është shtuar bashkëpunimit të veçantë me parti të ndryshme politike, sa në rrafshin programor, po aq edhe në atë ideologjik. Disa parti politike në Serbi, Bosnjë, Maqedoni dhe Mal të Zi kanë nënshkruar memorandume të bashkëpunimit me "Rusinë e Bashkuar" të Putinit. Këto parti politike filoruse në të ardhmen do të mund të përdoren brenda këtyre vendeve si faktorë politikë elektoral. Disa nga zyrtarët e tyre që shpesh e godasin publikisht Kosovën apo edhe përhapin pikëpamje antishqiptare flasin në emër të botëkuptimeve të errëta ruse. Këtu, listës i prin ministri i jashtëm serb Ivica Dačić dhe ai i mbrojtjes, Vulin, po ashtu Millorad Dodik në Banjallukë dhe Andrej Mandiq, por edhe disa të tjerë. Rusia përmes bashkëpunimit bilateral, investimeve në tregti e energjetikë ka për qëllim të kontrollojë sigurinë dhe ekonominë këtyre vendeve. Analizat e mirëfillta për instrumentet dhe mënyrën e ndikimit rus në aspektin ekonomik në rajon

japin një pamje të frikshme të këtij penetrimi. Kjo ka të bëjë me fushat dhe institucionet e ndryshme në shtete të veçanta, për shembull, pjesëmarrja e gazit rus në tregun e rajonit është shumë e madhe në Hungari rreth 80 për qind të tregut, në Bullgari rreth 90 për qind, në Serbi rreth 70 për qind dhe në Greqi rreth 40 për qind, edhe pse të dhënat ndryshojnë nga viti në vit. Prej këtyre të dhënave duhet kushtuar rëndësi nënshkrimet të marrëveshjes dhe pasojave për tregun rajonal. Serbia së fundmi ka nënshkruar marrëveshje të tregtisë së lirë me Bashkimin Ekonomik të Euroazisë. Kjo tregon se paralamërimet evropiane nuk i bëjnë përshtypje askujt në Beograd. Gjatë vizitës në Beograd, presidenti rus Putin përveç takimeve me homologët serb, përshëndetjes ushtarake nga artileria serbe dhe vizitës në Katedralen Shën Sava, pati pritje mirëseardhjeje nga rreth 100 000 qytetarë. Putini nuk pritet askund në Evropë. Vizita në Serbi do t'i shërbejë një lloj triumfi diplomatik, por nuk ishte ceremoniale në karakterin e saj. Më e rëndësishme është se çfarë ndodhi në margjina të vizitës, që në fakt ishte edhe qëllim i saj. U bë e ditur arritja e marrëveshjes me Serbinë për përfshirjen e kësaj të fundit në Turk Stream që synon sjelljen e gazit nëpërmjet Evropës Juglindore. Menjëherë pas vizitës Serbia u pajis edhe me katër MiG 29 nga Bjellorusia që shërben si një lloj shteti vasal i Rusisë. Disa aeroplanë ushtarakë Rusia ia kishte dhuruar pak kohë më parë Serbisë. Në këto rrethana, janë të pakuptimta disa pretendime të politikanëve evropianë të cilët sapo e hapën kapitullin tetëmbëdhjetë për Serbinë dhe e bllokuan Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ata duhet ta kuptojnë që Rusia dëshiron ta shndërrojë Ballkanin në një fushëbetejë me Perëndimin, një lloj 'vije të zjarrit'. Ajo synon ta sfidojë Perëndimin në çdo mënyrë, prej furnizimit ushtarak të shteteve të caktuara, përdorimit të instrumenteve ekonomike apo edhe fuqia e mprehtë (sharp power). Kjo e fundit ka të bëjë me luftën informative. Media, institute kinse hulumtuese e shkencore, politikanë individualë e deri te shërbimet e inteligjencës janë të përhapura në disa vende të rajonit për të

ndikuar drejtpërdrejt dhe për ta shtyrë përpara agjendën ruse. Nëse shtetet perëndimore, e mbi të gjitha BE-ja ka bërë përpjekje në dekadat e fundit që ta rrisë ndikimin e saj përmes fuqisë së butë, këtë po e bën Rusia përmes formave të ndryshme të saj. Qëllimet ruse pasqyrohen më së miri në numrin e artikujve dhe reportazheve në lidhje me Kosovën, gjatë viteve të fundit, në mediat e kontrolluara nga shteti si Russia Today dhe Sputnik. Aty shkruhen temat më negative për Ballkanin, ndërsa fokus i veçantë është Kosova. Sa herë ka tension politik, krizë qeveritare, apo zhvillime në raport me Serbinë ato i prezantojnë me diskurs të ashpër antishqiptar. Nuk është ndonjë fshehtësi që disa vende ballkanike për arsye politike, kulturore dhe ekonomike janë një terren i përshtatshëm për të qenë platforma të ndikimit rus. Kjo nuk vlen për Kosovën dhe Shqipërinë. Por, do të ishte naivitet të mendohet se ato nuk përbëjnë caqe të luftës hibride. Përkundrazi, për Kosovën lufta hibride ruse zhvillohet jo vetëm në nivel rajonal, por edhe në atë global. Rusia është kundërshtari më i madh strategjik që ka sot Kosova globalisht. Kjo bëhet për ta goditur shtetin e ri, shqiptarët në Ballkan, por edhe partnerët e saj - amerikanët dhe evropianët. Në fillim të shekullit 20, Rusia është përpjekur me çdo kusht që ta pengojë krijimin e shtetit shqiptar kurse në fillim të shekullit 21 - Kosovën e pavarur. Forma e re e luftës informative ruse kundër Kosovës ka lindur paralelisht me procesin e pavarësisimit të saj dhe vazhdon edhe sot. Në kohën e pushtimit serb dhe aparteidit në Kosovë më 1990, zyrtarë diplomatikë rusë në Beograd, që vinin herë pas here këtu, raportonin në detaje, por qëllimisht falsifikonin faktet. Ato raporte janë përdorur ndërkom-bëtarisht kundër kauzës së një populli të shtypur. Rreth dhunës serbe, shkeljeve masive të të drejtave të njeriut e deri te masakrat mbi civilët e pafajshëm, diplomatet dhe mediat ruse qëllimisht keqinformuan dhe manipuluan opinionin publik në Afrikë, Azi, Amerikë Latine dhe më gjerë. Meqë historikisht, Rusia ka qenë dhe vazhdon të jetë aleatja kryesore e Serbisë, pavarësimin e mundshëm të Kosovës e ka

shikuar si faktorizim të shqiptarëve në Ballkan. Në çdo forum dhe organizatë ndërkombëtare ka ofruar pamje të rreme dhe ka falsifikuar faktet në raport me Kosovën në OSBE, Këshill të Evropës dhe deri te Këshill i Sigurimit të OKB-së duke përfshirë organizata të ndryshme rajonale në gjeografi të largëta. Politikanë dhe diplomatë të shumtë që kam takuar derisa isha në pozita të ndryshme në Qeverinë e Kosovës kanë treguar lloj-lloj situatash e trillime ruse për Kosovën. Nga Tunizia e deri në Botswana, nga Barbados në Gajane dhe Pakistan, mund të shkruhet një libër i tërë me përrallat ruse për Kosovën. Mirëpo, të njëjtat ishin narrativa që treguan efekt në disa gjeografi. Rusia ka kundërshtuar intervenimin humanitar të NATO-së në vitin 1999 në kohën e një krize të madhe humanitare, kur masakrat serbe mbi qytetarët e pafajshëm ishin lajmet të tmerrshme në botë. Në qershor të vitit 1999, një formacion paraushtarak rus e mori në kontroll aeroportin e Prishtinës, me qëllim të krijimit të tensioneve të reja ndërmjet NATO-s dhe Rusisë, në një kohë kur krizës në Kosovë me vendosjen e trupave paqeruajtëse po i vinte fundi. Rusët kërkonin një sektor të veçantë në Kosovë jashtë komandës së NATO-s dhe qëllimi i lëvizjes së trupave paraushtarake do të ishte që të krijonin fakte në terren. Kështu, një bashkëpunim i deriatëherëshëm NATO - Rusi ishte afër që të shndërrohej në një konfrontim mes tyre. Një skenar, ky, me formacione paraushtarake që do ta shohim disa vite më vonë të përsëritur në gjeografi të tjera të Evropës Lindore. Më vonë, Rusia ka bllokuar miratimin e planit të Ahtisaarit në KS së bashku me pranimin e Kosovës në OKB edhe pse ka qenë e pjesë e pandashme e zgjidhjes së statusit final të Kosovës në kuadër të OKB-së. Ajo ka qenë pjesë e Grupit të Kontaktit për Kosovën që hartoi parimet drejt pavarësisë së Kosovës, dhe më pas ka qenë pjesë e Trojkës, amerikane, evropiane, dhe ruse. Mirëpo, bllokoi çdo marrëveshje në OKB nga vera e 2007 deri në fund të këtij viti. Ajo e ka penguar sepse ka dashur që me çdo kusht t'i ruajë zonat e influencës në Ballkan. Qasja ruse në raport me Kosovën në këtë kohë, nuk

kishte të bënte as me parime dhe as me procesin sepse ajo ishte pjesë e tij. Thelbi i një qasjeje të tillë ishte kryekëput gjeopolitik. Një Kosovë e pavarur do të ishte, natyrisht, pro-perëndimore dhe jashtë çdo ndikimi rus. E ka bërë këtë se dëshiron ta ndryshojë botën e krijuar pas 1989 dhe ta frenojë zgjerimin e demokracisë kudo në Ballkan.

Deri më sot, pengesa kryesore e pranimit të Kosovës në OKB mbetet Rusia dhe kështu do të jetë edhe në të ardhmen. Do ta kundërshtojë Kosovën kudo dhe kurdo që mundet. Deri më tani e ka bllokuar dhe goditur politikisht. Ka qenë refuzuese e çdo lloj komunikimi të rregullt me shtetin e ri. Politika ruse në raport me Kosovën duhet të shihet përtej asaj se çfarë thuhet sot në Moskë. Ajo është pasqyrim më i thellë i pikëpamjes ruse mbi Ballkanin. Ajo kundërshton Kosovën e pavarur jo vetëm se është thjesht pro serbe apo kundër shqiptarëve. Qasja e saj bazohet në interesat e drejtpërdrejta për të pasur zona të

influcës në mes të popujve sllavë ortodoksë në Ballkan dhe të tjerëve. Shqiptarët janë parë çdoherë në Ballkan, nga perspektiva ruse, si "trupa të huaj". Pas pavarësisë së Kosovës, Rusia është munduar që të ndikojë mbi zhvillimet në këtë vend përmes prezencës së reduktuar të UNMIK-ut. Në kuadër të këtij misioni shpesh janë kamufluar edhe agjentë të shërbimit rus, të cilët kanë qenë përcaktues në hartimin e raporteve sa më negative për Kosovën nga ky mision i OKB-së. Çfarë është shkruar shpesh në këto raporte ka qenë dhe është jashtë realitetit. Madje, raporti i dërguarit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë, i cili është munduar të jetë i balancuar është rishkruar në Nju-Jork nga diplomatë rusë para se ai ta prezantonte në formën finale për opinion publik dhe para shteteve anëtare të OKB-së. Në fakt, lajmi i parë i rremë ndërkombëtarisht është ky raport i rregullt kuartal dhe ka filluar ndër tjerash edhe me Kosovën.

Në planin global, Rusia ka kundërshtuar kudo njohjet e Kosovës me një imagjinatë morbide, duke prezantuar Kosovën si një shtet islamik dhe qytetarët e saj të prapambetur në aspektin ekonomik dhe kulturor. Ka bllokuar Kosovën në organizata të shumta ndërkombëtare me votën e saj kundër, duke kushtëzuar shtetet e tjera që të mos votonin pro Kosovës. Ka bërë përpjekje që ta suspendojë sovranitetin tonë sikurse rasti me Organizatën Botërore të Doganave duke bllokuar pagesën tonë të anëtarësisë apo të drejtën tonë për të votuar në organet e saj. Ka edhe organizata të tjera ku Rusia ka ndjekur një qasje shumëdimensionale agresive kundër Kosovës. Disa nga to madje janë shoqata profesionale nga fusha ekologjike e deri tek grupime të ndryshme. Qëndrimi rus është dukur se po zbutet dhe ka qenë diçka më neutral pas nisjes së dialogut për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë. Është parë si një situatë shpresëdhënëse dhe është dukur sikur diçka ka ndryshuar.

Rusia është munduar të paraqitet edhe si parimore, natyrisht në mënyrën e vet, dhe jo të parimeve apo të vlerave ndërkombëtare. Sidoqoftë, gjërat kanë marrë drejtim tjetër kur Rusia okupoj Krimenë dhe atëherë u pa qartë edhe fytyra e vërtetë e saj. Ajo përdori pavarësinë e Kosovës, padrejtësisht, si një rast krahasues për ta legjitimuar aneksimin ushtarak të Krimesë. Vet Putini e kishte udhëhequr luftën dezinformative kundër Kosovës duke bërë përpjekje që ta manipulonte opinionin publik ndërkombëtar. Në mars të vitit 2014, me rastin e nënshkrimit të aneksimit formal të Krimesë, Putini foli më gjatë se çdo herë tjetër për Kosovën, duke ngatërruar faktet me jo-faktet, dhe të vërtetat, me gënjeshtër. Qoftë shkatërrimi i Jugosllavisë, bërja e Kosovës së pavarur, vendimi i GjND-së, apo edhe njohja ndërkombëtare e saj, u interpretuan në shërbim të qëllimeve aneksuere ruse në raport me Krimenë. Asnjëherë në Rusi dhe nga mediat ruse nuk është folur më shumë për

Kosovën sesa në kontekstin e këtyre ngjarjeve pas-Krime. Ky narracion dhe paralelet ruse janë larg çdo realiteti.

Kosova është shprehur qartazi kundër këtij akti, i cili është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, duke ngritur zërin se Rusia shkeli normat ndërkombëtare dhe rrezikoi sigurinë e përgjithshme në Evropë. Kosova ishte e qartë në qëndrimin e saj sa i takon kësaj situatë duke bërë të ditur botërisht se kundërshton keqpërdorimin e rasti të saj si model krahasues për politikën ruse dhe ekspansioniste. Rusia, shpesh herë në argumentimet e saj për të përligjur aneksimin e Krimesë, në mënyrë implicite ka njohur të drejtën e Kosovës për shtetësi. Sidoqoftë, do të ishte naivitet të mendohej se Rusia do ta ndryshojë qëndrimin për shkak të ndërlikimit të rasteve. Jo sot! Sido që të jetë, Krimia ka qenë episodi më interesant dhe më goditës i luftës informative ruse kundër Kosovës, por narracioni rus për Kosovën është një lloj filmi i gjatë serik. (Vijon)

## Përrurohen hapësirat e rinovuara në Klinikën e Biokimisë



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Basri Sejdiu dhe ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, kanë përfunduar të enjten hapësirat e rinovuara në Klinikën e Biokimisë.

Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka thënë se përmes këtij investimi është bërë një tjetër hap i rëndësishëm për avancimin e shërbimeve mjekësore për qytetarët tanë. "Është një hap drejt modernizimit të klinikave që nënkupton zgjerimin e shërbimeve. Jemi duke i zgjeruar të gjitha investimet", u shpreh drejtori Sejdiu. Sipas tij, vlera e

investimeve është mbi 110 mijë euro dhe do të ketë investime edhe në aparaturë mjekësore. Gjatë përfundimit të kësaj klinike ministri Ismaili ka thënë se tani janë krijuar kushtet optimale për punë. "Një tjetër ditë e rëndësishme për sektorin e shëndetësisë. Klinika e Biokimisë, aty ku kryhen të gjitha analizat mjekësore, është transformuar

rrenjësish. Përmes këtij investimi do të rriten cilësia, siguria dhe vëllimi i punës", është shprehur ministri Ismaili.

Drejtori i Klinikës së Biokimisë, Shemi Veseli, ka theksuar se tani janë plotësuar parakushtet që Laboratori i Biokimisë të akreditohet edhe në federatat ndërkombëtare. Ai ka njoftuar se deri tani janë kryer një milion

parametra në laboratorët e klinikës. Klinika e Biokimisë deri tani ka funksionuar pa ventilim dhe profesionistët shëndetësorë janë rrezikuar vazhdimisht nga kimikatet e laboratorit.

Tani kjo klinikë ka ventilim adekuat, pritore të re për pacientë, dhoma optimale për kryerjen e analizave dhe për shërbime të tjera.



## Gjendet i vdekur në Badoc inspektori i Komunës së Prishtinës

PRISHTINË, 19 DHJETOR (ER) - Trupi i pajetë i një personi që është gjetur në pyll afër liqenit të Badocit është i njërit prej inspektorëve të pyllit të Komunës së Prishtinës me iniciale N. Rr. Policia e ka gjetur personin në fjalë të vrarë me armë zjarri, ndërsa vetura e tij ishte e braktisur.

Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, duke e treguar ngjarjen, ka theksuar se për komunën që drejton ky është një lajm i rëndë. "Mbrëmë

Drejtorja e Inspeksionit është lajmëruar se është gjetur vetura e braktisur/hapur e njërit prej inspektorëve më të vjetër të pyllit të Komunës së Prishtinës N. Rr. në afërsi të Badocit. Fatkeqësisht, pas arritjes së policisë është gjetur edhe trupi i pajetë i të ndjerit, i vrarë me armë zjarri, në zonën që e ruante si roje pylli", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Më tutje, Ahmeti ka bërë me dije se trupi i të ndjerit është

përcjellë në Institutin e Mjekësisë Ligjore për obduksion ndërsa policia, sipas tij, është duke i zhvilluar hetimet rreth rasti. "Familjes i shprehim ngushëllimet më të sinqerta dhe si komunë do t'i qëndrojmë pranë në këto çaste të vështira. Nga Policia kërkojmë që sa më parë të zbardhet rasti dhe kryesit e veprës të sillen para drejtësisë. Ky rast edhe një herë dëshmon rrezikun me të cilin përballen Inspektorët e Komunës", ka shkruar Ahmeti.



## Begaj prezanton para qytetarëve punën njëvjeçare të Komunës së Malishevës



MALISHEVË, 19 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, në kuadër të zbatimit të obligimeve ligjore, të enjten ka mbajtur dëgjimin e dytë publik me qytetarët e kësaj komune. Në këtë dëgjim Begaj ka prezantuar punën dhe aktivitetet e qeverisë komunale gjatë këtij viti. "Bazuar në të dhëna gjatë këtij viti ka vazhduar puna për realizimin e projekteve, duke filluar nga infrastruktura rrugore, kanalizimet, trotualet për të vazhduar me investime në arsim, me objekte të reja shkollore, kabinete, bursa për studentë dhe investime të

tjera. Po ashtu, investime ka pasur edhe në bujqësi, në shëndetësi, në mirëqenie sociale si dhe në kulturë, rini dhe sport", ka thënë Begaj.

Pas prezantimit të punës njëvjeçare është zhvilluar edhe debat me qytetarët e pranishëm. Në diskutimet e tyre qytetarët, krahas përgëzimeve për punët e kryera dhe angazhimet e komunës, i kanë shprehur edhe disa pakënaqësi, duke dhënë edhe vërejtje për cilësinë e punimeve në disa projekte, kryesisht në infrastrukturën e rrjeteve të kanalizimit, pasi në vazhdimësi ka probleme në funksionimin e tyre. Po ashtu,

qytetarët kanë paraqitur edhe kërkesa për angazhimet e komunës në vitet në vijim, për investime për të cilat qytetarët kanë nevojë.

Në këtë dëgjim publik me qytetarë ishte i pranishëm edhe deputeti i zgjedhur në Kuvendin e Kosovës, Fetah Rudi, i cili e ka përgëzuar kryetarin dhe qeverinë komunale për angazhimet e deritanishme, në veçanti për mirëmbajtjen e ambientit, ndërsa ka kërkuar angazhim të përbashkët për shtyrjen përpara të kërkesave të qytetarëve dhe realizimin e tyre jo vetëm nga niveli lokal, por edhe nga niveli qendror.

## Gjendja e sigurisë në Klinë, e qetë dhe pa probleme të mëdha

KLINË, 19 DHJETOR (ER) - Në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur takimin e gjashtë dhe të fundit për vitin 2019, ku është diskutuar për situatën e sigurisë në territorin e kësaj komune. Këtë takim e ka udhëhequr nënkryetari i Klinës, Besim Hoti, i cili i ka njoftuar të pranishmit se për këtë vit

është përmbushur kalendari i paraparë i takimeve të mbajtura nga ky këshill.

Ndërsa komandanti i Stacionit Policor në Klinë, Rexhë Berisha, ka thënë se situata e sigurisë në këtë komunë është e qetë dhe pa probleme të mëdha. Ai i ka njoftuar të pranishmit me statistikat e rasteve të paraqitura dhe me numrin e gjobave të shqiptuara.

Po ashtu, ai ka theksuar se Policia e Kosovës ka bërë të gjithë përgatitjet për ofrimin e sigurisë gjatë ditëve të festave të fundvitit. Në anën tjetër, të pranishmit kanë shprehur shqetësimet e tyre për problemet me të cilat përballen qytetarët, duke theksuar problemin e qeneve endacakë dhe rrjetin e vjetruar të energjisë elektrike.



## Nis asfaltimi i rrugës Runik - Syriganë

SKENDERAJ, 19 DHJETOR (ER) - Në Bashkësinë Lokale të Runikut ka filluar asfaltimi i rrugës Runik - Syriganë dhe segmenteve të tjera të rrugëve në këtë pjesë. Për t'i parë nga afër punimet e kësaj

rruge ka qenë i pranishëm nënkryetari i Skenderajt, Nuredin Lushtaku, së bashku me drejtore-shën e Urbanizimit, Sanije Ahmeti dhe me bashkëpunëtorë të tjerë. Po ashtu, edhe në lagjen 6 në

Skenderaj ka filluar asfaltimi i rrugës në këtë pjesë të qytetit. Me këtë rast, banorët e kësaj lagje janë shprehur mjaft të kënaqur me investimet që ka bërë komuna për realizimin e kërkesave të tyre.

## Komuna e Rahovecit ndalon përdorimin e mjeteve piroteknike

Rahovec, 19 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar urdhëresën për ndalimin e përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fundvitit. Këtë urdhëresë Latifi e

ka marrë duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës dhe pas kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për ndalimin e përdorimit të produk-

teve (mjeteve) piroteknike. Ndalimi i mjeteve përdorimit të mjeteve piroteknike vlen për periudhën 19 dhjetor 2019 deri më 15 janar 2020, kurse përjashtim bën 31 dhjetori 2019 prej orës 23:30

deri në orën 00:30 e 1 janarit 2020. Komuna e Rahovecit ka bërë me dije se personat të cilët shkelin këtë urdhëresë do të ndëshkohen me gjobë në shumën prej 100 eurosh.



## Po jetësohet projekti më i madh i energjisë së ripërtëritshme në Kosovë



Ka arritur të finalizohet e tërë procedura për Parkun e Erës në Bajgorë, i ndërmarrjes SOWI Kosovo, projekti më i madh i energjisë së ripërtëritshme në vend, i cili do të mundësojë hapjen e qindra vendeve të reja të punës. Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se projekti që parasheh investime prej 170 milionë eurosh ka gjetur mbështetje financiare edhe nga bankat prestigjioze Erste Group Bank dhe NLB Bank, kurse mbulesa financiare është ofruar nga Agjencia Gjermane Euler Hermes

dhe NLB Bank, derisa mbulesa financiare është ofruar nga Agjencia Gjermane Euler Hermes. "SOWI Kosovo, ndërmarrja me pronësi kosovare, gjermane dhe izraelite, që është investitorja e parë e shpallur strategjike në Kosovë, do t'i vendosë 27 turbina të prodhuesit General Electric në rajonin e Bajgorës, me kapacitet të instaluar prej 105 megavatësh, për të prodhuar energji elektrike pa dëme në mjedis. Kjo energji elektrike është më se e nevojshme në vendin tonë dhe, përveç të tjerash, me këto kapacitete ne përmbushim caqet për energji të ripërtëritshme më herët sesa që jemi zotuar", ka deklaruar Haradinaj, duke theksuar se projekti do të përfundojë së ndërtuari në vitin 2021.

E veçanta e projektit të SOWI Kosovo, sipas kryeministrit në detyrë, Haradinaj, është se ka bashkuar shtete të ndryshme, Kosovën, Gjermaninë, ShBA-në, Izraelin, Slloveninë dhe Austrinë,

derisa edhe përmbyllja financiare po bëhet pikërisht në ditëlindjen e shtatë të BERZh-it në Kosovë, e që është shembulli më i mirë i bashkëpunimit, në të cilin vendi ynë luajti rol aktiv dhe shumë të rëndësishëm.

Më tej, Haradinaj ka theksuar se ashtu sikurse ndërmarrja SOWI Kosovo, Qeveria e Kosovës gjatë këtyre dy vjetëve u ka qëndruar pranë të gjithë investitorëve në vend dhe atyre të huaj, duke ofruar gjithë përkrahjen. "Puna e përbashkët e institucioneve të Qeverisë dhe kompanisë SOWI Kosovo ka rezultuar në më shumë se 20 leje, kërkesa këto që rrjedhin nga korniza ligjore në Republikën e Kosovës", është shprehur Haradinaj, duke falënderuar administratën dhe personelin e Qeverisë së Kosovës për asistencën profesionale të ofruar dhe për profesionalizmin e treguar në procesimin e kërkesave të investitorëve të huaj dhe të ndërmarrjes SOWI Kosovo në veçanti.

Po ashtu, kryeministri në detyrë,

Haradinaj, ka falënderuar ambasadorin Christian Heldt dhe gjithë stafin e ambasadës Gjermane nën leadershipin e ambasadorit për një përkrahje të vazhdueshme për këtë projekt. Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, ka pohuar se kjo ishte një punë ekipore e vërtetë dhe se kjo tregon se kur të gjithë palët e interesit bashkëpunojnë, mund të bëhen gjëra që veprojnë mirë në Kosovë. "Siç e përmendi kryeministri, ky është projekti i parë i tillë në kornizën ligjore për investime strategjike. Unë si ambasador gjerman jam shumë krenar që një projekt i tillë në energjinë e ripërtëritshme mund të bëhet brenda kësaj kornize. Ka pasur shumë sfida dhe ky është momenti që t'i falënderojmë të gjitha palët e interesit nga ana e biznesit, gjithashtu edhe administratën e Kosovës, qeverinë dhe agjencitë që kanë luajtur rol të rëndësishëm për ta bërë këtë që të ndodhë", tha ambasadori gjerman, Heldt.

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 DHJETOR - "Për Kosovën ka filluar një epokë e re, epoka e investimeve strategjike, investim ky më i madh që ka ndodhur ndonjëherë në zhvillimin e Kosovës", kështu ka deklaruar të enjten kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, në konferencën e përbashkët për media me ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, duke njoftuar se është shënuar një sukses i madh për

Kosovën, pasi është finalizuar e tërë procedura për Parkun e Erës në Bajgorë, i ndërmarrjes SOWI Kosovo, projekti më i madh i energjisë së ripërtëritshme në vend, i cili do të mundësojë hapjen e qindra vendeve të reja të punës.

Haradinaj ka theksuar se është nënshkruar përmbyllja financiare me BERZh-in dhe ka bërë me dije se projekti që parasheh investime prej 170 milionë eurosh ka gjetur mbështetje financiare edhe nga bankat prestigjioze Erste Group Bank

## Matoshi premton zgjidhjen e problemit të ndotjes së mjedisit nga qeset e plastikës



Prishtinë, 19 dhjetor (ER) - Ministri në detyrë i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, ka vlerësuar se ndër armiqtë më të mëdhenj të vendit sa i përket mjedisit janë qeset dhe shishet e plastikës. "Qeset e plastikës i kemi çdo kund, në natyrë, brezit rrugor, për më tepër janë përdorur edhe si mjet për të mbled-

hur mbeturina dhe prapë janë hedhë në rrugë", ka thënë ai gjatë konferencës përmbyllëse të projektit "Për një jetë të shëndetshme, pa qese plastike".

Ai ka thënë se rekomandimet që dalin nga kjo konferencë do të merren parasysh deri në marrjen e vendimit përfundimtar sa i përket të ardhmes së përdorimit të qeseve të plastikës në

vendin tonë. Sipas tij, rreth përdorimit të qeseve të plastikës do të merret një vendim që do të jetë i pranueshëm nga palët dhe rrethanat shoqërore në vendin tonë.

Projekti "Për një jetë të shëndetshme, pa qese plastike" është financuar nga MMPH-ja dhe është zbatuar nga Kosovo Center for Business Support (KCBS).

# Kosova, në prag të krijimit të qeverisë, pritshmëri të larta qytetare



Prof. Lisen BASHKURTI

Më 6 tetor 2019 Kosova bëri zgjedhjet e parakohshme politike. Për arsye teknike dhe ligjore të arsyeshme rezultati u certifikua më 27 nëntor. Nga fundi i nëntorit deri më 26 dhjetor 2019 konstitucionalisht është afati kohor për t'u konstituuar Kuvendi, zgjedhja e kryesisë, kryetari, grupet parlamentare dhe më pas qeveria. Ndërkohë, kanë vazhduar negociatat midis dy forcave kryesore fituese të dala nga vota popullore, LV-ja dhe LDK-ja. Pak ditë më parë kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër, Albin Kurti, deklaroi se qeveria e re do të formohet së shpejti. Gjatë kësaj periudhe media dhe burime të ndryshme jashtë negociatore kanë ushqyer opinionin politik dhe publik të Kosovës, Shqipërisë dhe atë ndërkombëtar me opsione, skenarë dhe alternativa nga më të ndryshmet, e herë-herë nga më të çuditshmet. Ajo çka bie në sy është fakti se shumica e analistëve dhe opionistëve, sidomos në Kosovë dhe Shqipëri, flasin pa marrë parasysh, për arsye mosnjohje ose të tjera, procedurat kushtetuese për konstituimin e Kuvendit, organeve të tij dhe të qeverisë së re.

## 1. Çdo gjë brenda afateve dhe procedurave kushtetuese

Referuar Kushtetutës së Kosovës është presidenti i cili e thërrret seancën konstituive të Kuvendit pas certifikimit të rezultateve zgjedhore. Siç dihet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës ka certifikuar më 27 nëntor rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të mbajtura më 6 tetor 2019. Duke u bazuar në numrin e votave të fituara, Lëvizja Vetëvendosje ka 29 deputetë në Kuvendin e Kosovës, LDK-ja ka 28, PDK-ja 24 deputetë, koalicioni AAK-PSD 13 deputetë, Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë 6 deputetë. Ndërkaq, nga komunitetet e pakicave Lista Serbe ka 10 deputetë, ndërsa të gjitha partitë e pakicave joserbe së bashku kanë fituar 10 vende. Gjithsejtë, Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, prej të cilëve 20 vende janë të rezervuara për komunitetet pakicë, respektivisht 10 vende për komunitetin serb

dhe po aq vende për komunitet e tjera pakicë.

Referuar Nenit 66 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, parashihet edhe procedura e konstituimit të Kuvendit pas zgjedhjeve. Në këtë nen përcaktohet se Kuvendi i RK zgjedhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive të tij. Kryetari dhe kryesia e legjislaturës së re të Kuvendit të Kosovës, në pajtueshmëri me legjislacionin relevant në fuqi, duhet ta përgatisin propozimin e rendit të ditës për mbledhjen e parë të përbërjes së re të Kuvendit. Në seancën e parë konstituohet Kuvendi zgjedhet kryesia, kryetari i legjislaturës së shtatë, si dhe grupet parlamentare.

Nëse nuk arrihen votat e nevojshme nuk mund të konstituohet Kuvendi, çka parakupton mosarritjen e marrëveshjes së palëve fituese të zgjedhjeve. Në rastin e dhënë LV-ja dhe LDK-ja duhet ta arrijnë marrëveshjen, që të kenë 61 vota për ta zgjedhur kryetarin, kryesinë dhe grupet parlamentare. Pas konstituimit të Kuvendit presidenti cakton mandatarin për formimin e qeverisë, në rastin e dhënë Albin Kurti, i cili duhet t'ia kthejë përgjigjen presidentit se mund ta krijojë qeverinë, atëherë mbahet seanca përkatëse dhe që të zgjidhet qeveria. Nëse mandatori nuk mund t'i bëjë 61 deputetë për herën e parë, atëherë Kushtetuta thotë se mundet edhe një herë t'i rikthehet sërish mandati nga presidenti për 10 ditët e tjera në vijim. Nëse sërish mandatori nuk arrin ta formojë qeverinë, brenda 40 ditëve në vazhdim vendi shkon në zgjedhje të reja, të parakohshme. Deri tani, çdo gjë shkon në përputhje me parashikimet kushtetuese.

## 2. Negociata parimore, jo pazare postesh e funksionesh

Procesi i negociatave midis LV-së dhe LDK-së deri tani duket që të ketë qenë parimor, dhe jo pazare, siç kemi parë dhe dëgjuar nga përvojat e mëparshme në Kosovë por, jo vetëm. Të dy liderët, Albin Kurti (LV) dhe Isa Mustafa (LDK), janë treguar të matur dhe të vetëpërmbytshëm në deklaratimet, qëndrimet dhe veprimet e tyre. Këtu, që të mos gabojmë, duhet të mos konfundojmë negociatat reale, që burojnë nga faktorët brenda negociatorë, nga komentet, opinionet dhe analizat e faktorëve jashtë negociatorë. Deri tani nga faktorët brendane-gociatorë, në mënyrë të dakordësuar, është deklaruar se është arritur marrëveshja principale për ta krijuar qeverinë së bashku. Pra, nuk ka, parimisht, asnjë shkak për të mos bashkëqeverisur.

Së pari, principaliteti për bashkëqeverisje LV-LDK buron, para së gjithash, nga vota popullore, e cila ka zgjedhur LV-në dhe LDK-në për të qeverisur vendin dhe, nga ana tjetër, për të kaluar në opozitë, partitë e krahut të luftës, PDK, AAK, Nisma, të cilat e kanë qeverisur Kosovën prej shumë vitesh. Mbështetja popullore ka 'vulosur' bashkëqeverisjen LV-LDK. Kjo është principale dhe askush nuk guxon ta injorë apo ta shkelë atë, sepse bie legjitimiteti i votës qytetare.

Së dyti, marrëveshja e deritanishme midis LV-së dhe LDK-së duket të jetë principale dhe jo pazare, për faktin se palët janë dakordësuar ta zvogëlojnë qeverinë në 12 ministri, pra afro gjysmë për gjysmë. Ky zvogëlim i qeverisë është modeli i Xhorxh Uashingtonit, i cili deklaroi për "limited and no money government", pra për "qeveri të vogël dhe me shpenzime minimale". Duke zvogëluar qeverinë, LV-ja dhe LDK-ja kanë të bërë të kundërtën e qeverive paraardhëse të Kosovës, që kanë qenë të stërmëdha dhe me shumë shpenzime. LV-ja dhe LDK-ja, me zvogëlimin e qeverisë, kanë treguar qartësisht se marrëveshja e tyre nuk është pazar postesh dhe përfitimesh personale e politike, që do ta kërkonte vazhdimin e në mos rritjen e një qeverie të madhe, si të paraardhësit e tyre, por është marrëveshje parimore për qeverisje të mirë, të vogël dhe ekonomike. Kjo reformë strukturore e qeverisë do t'i ketë disa vlera të mëdha si janë: reduktimi i burokracisë shpenzuese, pastrimi i administratës publike qendrore nga politizimi, paafësia, nepotizmi dhe krahinarizmi; dhënia fund rekrutimeve në administratë publike bazuar në 'shpërblime partiake'; vënia e administratës mbi baza karriere meritokratike, profesionale, me procedura

transparente dhe konkurruese.

Së treti, marrëveshja midis LV-së dhe LDK-së duket të jetë principale edhe për prioritetet kryesore ku palët janë dakordësuar për programin e qeverisjes. Caktimi i prioritetëve të unifikuar nga të dyja palët është me rëndësi thelbësore për mirëqeverisjen e vendit. Kjo nuk ka qenë e lehtë. Duke pasur parasysh se LV-ja dhe LDK-ja kanë ndryshime në filozofinë politike, në alternativën ekonomike si dhe përvojat qeverisëse. Prioritetet qeverisëse i kanë artikulluar politikisht dhe publikisht të dyja palët. Para do kohe, në një takim me përfaqësuesit e shqiptarëve në Mal të Zi, Albin Kurti theksoi në mënyrë të përvijuar se "prioritete të kësaj qeverie janë punësimi dhe drejtësia". Pra, qeveria e re, LV-ja dhe LDK-ja do t'i kthehen agjendës qytetare, që është zgjidhja e problemeve ekonomike e sociale me të cilat përballen qytetarët e Kosovës dhe forcimi i shtetit ligjor, ose sundimi i ligjit, në luftë me korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Së katërti, marrëveshja e dakordësuar midis LV-së dhe LDK-së duket që të ketë arritur në qëndrime të përbashkëta në politikën e jashtme të Kosovës. Në këtë aspekt, është thelbësore që LV-ja dhe LDK-ja duket t'i kenë unifikuar qëndrimet për vijimin e dialogut me Serbinë siç janë: përpilimi i kuadrit të parimeve negociuese, si reciprociteti, pacënueshmëria e pavarësisë, sovranitetit, tërësia dhe integriteti territorial i Kosovës. Palët, gjithashtu, janë mjaft të përafuara që në platformën e negociatave të kërkojnë nga Serbia kërkim falje për krimet dhe gjenocidin e bërë mbi popullin shqiptar në Kosovë, gjetjen e viktimave, të humburit dhe kthimin e tyre në Kosovë, reparacionet për dëmet

ekonomike përpara dhe gjatë luftës 1998-1999, zgjidhjen e problemit të pensioneve dhe kontributeve të tjera të qytetarëve të Kosovës nga koha e Jugosllavisë, Unioni Serbi-Mal i Zi dhe të Serbisë përpara vitit 1999, e çështje të tjera teknike me interes shtetëror dhe qytetar.

Me shumë rëndësi është që LV-ja dhe LDK-ja janë deklaruar veç e veç, por edhe së bashku që procesi i negociimit me Serbinë të kalojë përmes një procedure kushtetuese, demokratike, pra të miratohet në Kuvendin e Kosovës, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe plotësisht transparente. Këtë proces, sikundër janë deklaruar palët, do ta udhëheqë Qeveria e Kosovës, pra kryeministri i pritshëm, Albin Kurti dhe jo presidenti Thaçi. Ky ndryshim thelbësor në udhëheqjen e negociatave është, në fakt, rikthimi i politikës së jashtme në binarët kushtetues, sipas të cilit, në Kosovë është qeveria institucioni legjitim për ta udhëhequr atë.

Natyrisht parashtrimi i mësipërm është principal, sepse programi i qeverisë së re të Kosovës neget për t'u parë e konsideruar plotësisht mbas paraqitjes dhe miratimit të tij në Kuvendin e Kosovës. Sikundër, aspekte të tjera informale të negociatave, dendurisht të përfolura në media, siç është zgjedhja në parim e presidentit të ardhshëm të Kosovës më 2021 nga radhët e LDK-së, janë jashtë kontekstit aktual formal-kushtetues. Deri tani, nga LV-ja dhe LDK-ja duket se janë përvijuar strategjia e përbashkët, prioritetet kryesore, struktura dhe parimet qeverisëse, të cilat japin shpresë se pritshmëritë e larta të qytetarëve të Kosovës për qeverinë e re, të dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit 2019, do të përmbushen më së miri.



## Putini mbron Trumpin

MOSKË, 19 DHJETOR - Presidenti rus Vladimir Putin deklaroi se procesi i shkarkimit të Donald Trumpit është i mbështetur i gjithi në akuzat "të sajura". Duke folur në Moskë, në konferencën e tij vjetore për mediat, shefi i Kremlinit tha se pret që Trumpi të mbetet në detyrë, pavarësisht se Dhoma e Përfaqësuesve votoi pro akuzave ndaj tij. "Procesi ende duhet të kalojë në Senat, ku republikanët, me sa di unë, e kanë shumicën. Partia që humbi zgjedhjet thjesht po e vazhdon luftën me mënyra të tjera", ka qenë koment i tij. Me këtë

pohim të fundit, Putini iu referua Partisë Demokratike në ShBA. Dhoma e kontrolluar nga demokratët votoi për dy akuzat kundër Trumpit: abuzim pushteti dhe pengim të punës së Kongresit, por vendimi përfundimtar për shkarkimin pritet të merret në Senatin e kontrolluar nga republikanët. Putini e krahasoi procesin për shkarkimin e Trumpit me hetimet e mëherëshme ndaj presidentit amerikan lidhur me pretendimet për bashkëpunim me Rusinë, edhe këto, sipas kreut të shtetit rus, të pabazuara.

Në një konferencë me gazetarë të mbuluar nga një numër rekord gazetarësh të akredituar rusë e të huaj, gati 1900, Putini tha se Rusia është e gatshme të bjerë dakord për një traktat të ri të armëve me Shtetet e Bashkuara, por shtoi se për propozimet ruse deri tani nuk ka pasur ende një përgjigje. Konferenca televizive është një ngjarje e rregullt e Putinit, të cilën ai e shfrytëzon për ta lartësuar imazhin e tij, për t'i siguruar rusët se ata janë në duar të mira dhe për t'u dërguar sinjale ShBA-së dhe pjesës tjetër të botës.



# Çfarë ndodh tani me presidentin Trump?

Donald Trump u bë presidenti i tretë i ShBA-së në histori që një president i nënshtrohet procesit të shkarkimit në bazë të shkeljeve të parashikuara në Kushtetutë, pasi që Dhoma e Përfaqësuesve e Kongresit amerikan miratoi të mërkurën në mbrëmje dy akuzat për shkarkimin e tij. Për ta shpallur fajtor duhen dy të tretat e votave të Senatit 100-anëtarësh

WASHINGTON, 19 DHJETOR - Dhoma e Përfaqësuesve zyrtarisht akuzoi të mërkurën presidentin e Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, për abuzim të pushtetit dhe pengim të punës së Kongresit. Gjykimi i tij kalon tani në Senat, ku ligjvënësit do të vendosin nëse do ta largojnë nga detyra ose jo. Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga demokratët, duhet t'i emërojë "menaxherët" që do ta paraqesin rastin kundër Trumpit në Senat. Ata mund të emërohen këtë javë ose pas festave të fundvitit, ka njoftuar rfe. Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, tha pas votimit të dy akuzave, se i duhen më shumë informacione nga Senati përpara se t'i emërojë menaxherët. Udhëheqësi i shumicës republikane në Senat, Mitch McConnell, dhe udhëheqësi i pakicës demokratike, Chuck Schumer, kanë pikëpamje krejtësisht të kundërta për mënyrën se si duhet të zhvillohet gjyqi. Ata tani pritet të negociojnë privatisht dhe përmes mediave.

Pelosi nuk tha se kur do t'i dorëzojë akuzat në Senat, gjë që është e nevojshme të bëhet përpara se të nisë gjyqi. Trumpi do të përballet me gjykimin në Senat, i cili do të vendosë nëse ai duhet të dënohet dhe të hiqet nga detyra. Senati kontrollohet nga Partia Republikane e Trumpit, e cila ka treguar pak shenja se do të votojë për shkarkimin e tij. Për ta shpallur fajtor Trumpin duhen dy të tretat e votave të Senatit 100-anëtarësh. Shefi i drejtësisë amerikane, John Roberts, do ta kryesojë gjyqin. Menaxherët e Dhomës së Përfaqësuesve do ta paraqesin rastin e tyre kundër Trumpit, ndërsa ekipi ligjor i presidentit do të përgjigjet. Senatorët do të veprojnë si anëtarë jurie. Gjyqi mund të përfshijë dëshmitë të dëshmitarëve dhe mund të zhvillohet gjashtë ditë në javë, për gjashtë javë. McConnell ka thënë se shumica e Senatit mund të miratojë një proces më të shkurtër, duke i votuar akuzat pas paraqitjes së



argumenteve, pa dëshmitarë. Presidenti mund të zgjedhë nëse do të paraqitet vetë para Senatit, por gjasat më të mëdha janë që ai të prezantohet nga avokati i Shtëpisë së Bardhë, Pat Cipollone. Cipollone, ashtu si edhe menaxherët, do të mund t'u shtrojnë pyetje dëshmitarëve dhe të bëjë deklaratat hyrëse dhe përmblyëse. Mediat amerikane raportojnë se Trumpi mund të sjellë edhe disa konservatorë në ekipin e tij mbrojtës, si kongresistin e Ohajos, Jim Jordan, ose atë nga Teksasi, John Ratcliffe. Trumpi akuzohet se i ka bërë presion Ukrainës për të zbuluar informacione të dëmshme për

Joe Bidenin, i cili mund të jetë rival i tij në zgjedhjet e vitit 2020. Trumpi akuzohet edhe për pengim të punës së Kongresit, pasi ka refuzuar të bashkëpunojë në hetime. Nëse Biden do të dëshmojë në Senat, kjo varet se si McConnell e përcakton formatin e gjyqit. Sipas medieve amerikane, republikanët vazhdojnë të diskutojnë nëse ia vlen të thirret për dëshmi ish-nënpresidenti demokrat. Biden i ka hedhur poshtë thirrjet për dëshmi, duke i thënë NPR-së se ato janë përpjekje të presidentit për të tërhequr vëmendjen nga akuzat kundër tij. Por ende nuk dihet nëse gjykimi do t'i ndikojë zgjedhjet e vitit

2020 në ShBA. Republikanët thonë se procedurat për shkarkimin e presidentit kanë ndihmuar në mbledhjen e fondeve për fushatën e Trumpit, pasi mbështetësit e tij janë anuar edhe më shumë kah ai. Për demokratët, kjo është një njollë e zezë në emrin e presidentit, të cilën votuesit do ta kenë të pamundur ta injorojnë. Sondazhet tregojnë se ndarja e opinionit, për dhe kundër presidentit, nuk ka ndryshuar shumë për shkak të procedurave të shkarkimit. Zgjedhjet presidenciale në ShBA do të mbahen në nëntor 2020. Trumpi do të garojë për rizgjedhje, ndërsa rivali i tij demokrat nuk dihet ende.

## Parlamenti gjerman kërkon të ndalohet Hezbollahu

BERLIN, 19 DHJETOR - Parlamenti gjerman miratoi të enjten një mocion, përmes të cilit i kërkohet qeverisë së kancelares Angela Merkel t'i ndalojë të gjitha aktivitetet e grupit Hezbollah në territorin gjerman, duke përmendur "aktivitetet e tij terroriste" veçanërisht në Siri. Grupi militant shiit i Libanit, Hezbollah, gëzon mbështetjen e Iranit, ndërkaq është shpallur organizatë terroriste nga ana e Shteteve të Bashkuara. Mocioni nuk është detyrues, por

do ta rrisë presionin ndaj qeverisë gjermane për të vepruar. Në dokument thuhet se Gjermania nuk duhet të bëjë dallim midis krahut politik të Hezbollahut dhe njërive ushtarake, të cilat kanë luftuar përkrah ushtrisë së presidentit Bashar al-Asad në Siri. "Parlamenti i bën thirrje qeverisë të ndalojë Hezbollahun dhe të mos tolerojë asnjë veprimtari nga përfaqësuesit e saj në Gjermani", thuhet në mocion. ShBA-ja dhe Izraeli po i kërkojnë

në vazhdimësi Gjermanisë të ndalojë tërësisht Hezbollahun, duke hedhur poshtë pretendimet se krahu politik dhe ushtarak janë entitete të ndara. Mbretëria e Bashkuar, në muajin shkurt, miratoi legjislacionin që e klasifikon Hezbollahun si një organizatë terroriste, duke përmendur aktivitetet ushtarake në Siri, Irak dhe Jemen. Bashkimi Evropian e konsideron vetëm krahun ushtarak të Hezbollahut si një organizatë terroriste dhe jo krahun politik.



Eshaloni i UÇK-së në luftë me forcat armike të pritës dhe dimrin e acartë në Pashtrik (11)

# NAZMI DHE SHERIF BELLAQA U ZUNË TË GJALLË NË GOROZHUP PRANË KARAKOLLIT



LULZIM SAHITI

Pas shpërthimit të luftimeve, luftëtari i lirisë, Nazmi Bellaqa dhe djali i xhaxhait të tij, Sherif Bellaqa, kishin humbur kontaktin me grupin e ushtarëve nga Rahoveci, të cilin e përbënin: Mensur Zyberaj, Xhevdet Mekani, Vesel Krasniqi, Hashim Gashi, Bajram Popaj dhe Ilir Popaj. Pas rezistencës së ashpër me forcat armike, fillojnë tërheqjen gradualisht e të vetmuar, por pa ditur orientimin se ku po shkojnë. Prapa tyre në një distancë të largët vinte edhe një ushtar tjetër, por nuk kishin kurrfarë kontakti me të. Duke ecur nëpër borë, që herë pas here këtë terren e mbulonte mjegulla e dendur, shkojnë afër një vendbanimi dhe nga gëzimi që kanë arritur në territorin e Shqipërisë, Sherifi gjuan në ajër me pushkë automatike. Menjëherë reagon Nazmiu duke ia kapur automatikun nga dora ngaqë kishte pasur dyshim për vendin. Nuk ka zgjatuar shumë kohë vijën afër vendbanimit dhe pak pa u errësuar hyjnë në brendi të fshatit të panjohur. Forcat serbe gjatë gjithë kohës i kishin mbajtur nën vëzhgim dhe vetëm pritnin momentin e volitshëm për t'i arrestuar. Duke ecur në mes dy mureve të oborreve me gurë, papritmas dëgjohej britma serbe "Stoj!" (Ndalu!). Distanca ndërmjet tyre ishte vetëm 7-8 metra. Nazmiu dhe Sherifi plandosën për toke, duke u pozicionuar për dyluftim. Fillon gjuajtja e ndërsjellë. Nazmiu e merr një plumb i armikut në këmbën e majtë (në kukë). Në këto çaste, Sherifi i afrohet për t'ia dhënë ndihmën e parë. Për një moment ka kërcyer nga muri një ushtar serb, i cili e godet me kondak të pushkës në kokë Nazmiun dhe 4-5 të tjerë i vijnë në ndihmë për t'i neutralizuar dy ushtarët e UÇK-së. Më nuk kishin asnjë mundësi për të rezistuar. Jo shumë larg këtij vendi kishte qenë Karakolli i Ushtrisë Jugosllave në Gorozhup. Aty i dërgojnë duke i rrahur pa mëshirë. Në oborr të karakollit, me duar të lidhura i shtrijnë midis bore duke i keqtrajtuar

fizikisht. Në ndërkohë shkojnë monitoruesit ndërkombëtarë të OSBE-së, të cilët marrin shënime nga dy ushtarët e zënë rob dhe kthehen pastaj në bazën e tyre në Prizren. Në ndërkohë, për një çast, shihen duke ardhur ushtari fatkeq i UÇK-së teposhtë gjurmëve të shtegut të njëjtë nga kishin ardhur dy ushtarët tashmë në duar të kriminelëve serbë. Dy pjesëtarë të forcave armike fillojnë të gjuajnë me snajper në drejtim të "terroristit" siç e quanin ata. Shtyheshin ndërmjet vete se cili po e qëllon. Për çudi edhe luftëtari i lirisë gjuante në drejtim të tyre por, largësia ishte rreth 500 metra. Për një çast, del nga karakolli një oficer, i cili merr në shënjestër duke e goditur të ndjerin. Mandej, i dërgoi dy ushtarë për ta sjellë trupin e pajetë. Ata e sollën zvarrë duke tërhequr për dy këmbë me kokë nëpër borë. Në oborr ia heqin uniformën për të parë ku është goditur viktimja. I ndjeri supozohet të ketë qenë nga zona e Drenicës. Mandej, dy ushtarëve të zënë rob i kërcënuan se kështu do t'i pushkatojnë. Ndërsa një ushtar i ri në moshë, nga keqardhja që ndiente për të zënë peng, nga Karakolli, ua ka hedhur një batanije për t'i mbuluar meqë nata ishte shumë e ftohtë. Mirëpo, një tjetër e qortoi veprimin e ushtarit në fjalë dhe ia mori batanijen. "Këta deshën me na vra e ti i mbulon me batanije", murmuriste i nevrkosur ushtari tjetër. Fshati Gorozhup nga fushëbeteja ka një distancë prej 12 kilometrash. Në orët e vona të mbrëmjes i hipin në "Pinzgauer" dhe me tyta të automatikut mbi

kokë i dërgojnë në Kazermën e Ushtrisë Jugosllave në Prizren, ku takohen me ushtarët e tjerë të zënë rob.

## Dy të plagosurit rëndë vendosen në tendën e ushtrisë jugosllave

Diku në thellësi të luginës së Pashtrikut, në agimin e hershëm të 14 dhjetorit, kishte mbetur i plagosur rëndë Azem Suma, i cili kishte provuar të tërhiqet zvarrë nja 10-15 metra, mirëpo sërish qëllohet nga plumbat e armikut. Kishte mbetur në mëshirën e fatit dhe tek në orët e vona të pasdites është vërejtur nga ushtarët serbë që ishte gjallë. Mandej, ata së bashku me Samet Ballazhin dhe shokët e tij ndihmojnë për tërheqje nga ky vend i kobshëm. E vendosin në një xhakët të gjatë të shiut, e cila kishte mbetur nga luftëtarët e tërhequr të UÇK-së. Së bashku me ushtarët serbë e tërheqin zvarrë të plagosurin në fjalë. Tërheqja bëhej lehtë ngase xhaketa e shiut rrëshqiste nëpër borë. E dërgojnë teposhtë te tenda dhe e vendosin brenda saj. Ndërkohë aty e sjellin edhe Enver Krasniqin. Në këtë tendë ushtarake, dy pengjet e plagosur e kalojnë natën së bashku me një ushtar të komunitet rom të Kosovës që shërbente për Ushtrinë Jugosllave. Ai e fliste gjuhën shqipe dhe bëhej sikur ndiente keqardhje për gjithë ngjarjen e përgjakshme. Ai tregonte pa e pyetur askush që dy ditë radhazi forcat jugosllave kanë qenë duke pritur ardhjen e pjesëtarëve të UÇK-së. Këto që

thoshte ky rom, ushtarëve të plagosur nuk u bënte fare përshypje dhe e konsideronin si provokim. Fundja, ata kishin dhembjet e plagëve të veta dhe shokëve të rënë në fushëbetejë. Kishte zbardhur mëngjesi pa ngrënë, e pa vënë gjumë në sy, vetëm për ujë të pijes, pjesëtari i UJ-së u kishte shkrië borë në një tas dhe u kishte dhënë dy të plagosurve për ta shuar etjen. Përfundimtarisht dëgjohej ardhja e helikopterit. Ushtarët serbë i vendosin të plagosurit veç e veç në lesë dhe i dërgojnë në helikopter, pas tyre i bartin edhe kufomat e ushtarëve të UÇK-së, të cilat, po ashtu, i vendosin aty. Filloi fluturimi pa ditur se ku po shkojnë. Mirëpo, udhëtimi në qiellin e hapur të Kosovës nuk zgjati shumë ngaqë helikopteri i ushtrisë jugosllave aterroi në oborrin e Kazermës Ushtarake në Prizren.

## Nëntë pengje paraburgosen në Kazermën Ushtarake të Prizrenit

Nga helikopteri bartën 35 trupat e pajetë për në Morgun e Spitalit të Prizrenit, ndërkaq dy të plagosurit i bëjnë bashkë me të zënë e tjerë peng. Të gjithë i kishin vendosur në një kafaz me shufra hekuri të ndarë në mes me kangjella, në të cilin shiheshin ndërmjet vete të dy grupet. Një ushtar i rregullt bënte roje pranë të burgosurve në Kazermë dhe e fliste gjuhën shqipe rrjedhshëm, por nuk dihej nacionaliteti i tij. Atij ia sollën mëngjesin, por ai nuk e hëngri. Këtë ushqim ua dha

nëntë të burgosurve, të cilët e shpërndanë në mes vete për ta shuar sadopak urinë. U sugjeroi ta hanë shpejt nga frika se po i shihte ndokush nga eprorët ushtarakë.

Në ora 8:00 fillojnë punën pjesëtarët e sigurimit ushtarak serb me veshje civile, ku nisi intervistimi dhe rrahja brutale ndaj ushtarëve të prangosur të UÇK-së. Me një fjalë, filloi ferri i vërtetë për pengjet e luftës, ndaj të cilëve është ushtruar terror e dhunë e pamëshirshme. Në fushëbetejë, Azem Suma kishte marrë një plagë në këmbën e majtë, ku plumbi i kishte lënë një vrimë të hapur. Kriminelët që ishin aq sadistë, mu në plagë ia vendosin shkopin e gomës derisa prekte tek ashti i këmbës. Përfundimtarisht dhimbje e tmerrshme. Ndërkaq, të plagosurin tjetër Enver Krasniqi fillimisht e zhveshin dhe e lënë vetëm në brekë. Mandej nisin ta marrin në pyetje duke ia shkelur plagët me çizme. Ishte torturë e egër çnjerëzore që shkaktohte mundim të rëndë shpirtëror. Me "procedurë" të ngjashme veprohej edhe me pengjet e tjerë. Mandej një ekip televiziv i TV Beogradit ka intervistuar Enver Krasniqin dhe Azem Sumën, të cilën intervistë më pas ky medium serb e ka transmetuar për 25 minuta. Për tri net e katër ditë i mbajnë me duar të lidhura mbrapa të mbështetur për muri, pa gjumë, pa ngrënë e pirë asgjë. Ata që nuk arrinin të qëndronin në këmbë ndëshkoheshin me dajak. Mandej, pas tri dite, tetë ushtarët i transferojnë me helikopter në Burgun Ushtarak të Nishit, ndërkaq Xhavit Daut Krasniqin, 17-vjeçar, ia shkulin emblemën e UÇK-së nga krahu si dhe e ndalojnë në kazermë. Atë e mbajnë katër net duke e keqtrajtuar fizikisht për çdo ditë dhe në mbrëmje, me tesha veshur, e dërgojnë në banjë, duke e mbajtur nën ujë të ftohtë për 10-15 minuta. Për pesë ditë e katër net nuk i japin ushqim fare, vetëm e lejojnë të pijë ujë. Pas katër dite, më 18 dhjetor 1998, Xhavitin duarlidhur e hipin në një veturë "Zastava 128", të shoqëruar me katër policë, të cilin e dërgojnë në Burgun Ushtarak të Nishit. Atje asnjërin nga shokët nuk kishte arritur t'i shihte. Për dhjetë ditë është mbajtur në qeli i vetmuar. Mandej ia sjellin një ushtar serb të plagosur në këmbë nga UÇK-ja në Junik, i cili kishte dezertuar nga ushtria serbe. Gjatë qëndrimit në burg, të burgosurit shqiptarë nja dy-tri herë ishin vizituar nga përfaqësuesit ndërkombëtarë të OSBE-së. (Vijon)



Pamje nga vendi i Karakollit "Gorozhup", i bombarduar nga NATO në vitin 1999



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Intervistë me Violeta MURATI

# Entela Tabaku & Shqiptar Oseku: Shkëputja nga gjuha mëmë e nga kujtesa shoqërore është një traumë e heshtur

Një herë mërgimtar, gjithmonë mërgimtar. Por njeriu nuk bëhet mërgimtar menjëherë kur lë vendlindjen e vet. Ai bëhet mërgimtar pas njëfarë kohe në mërgim...Ka një ndjenjë të fortë dhimbjeje, por edhe vetëndërgjegjësimi për jetën. Ajo çfarë ka ngjarë me ju, duke na e zëbërthyer në një vëllim poetik të përbashkët. Si lindi ideja, çfarë keni ndarë së bashku pas kësaj përvoje letrare?

Ideja ishte e përbashkët, ne kish kohë që kishim vënë re se eksperiencat tona, ndonëse dallonin në shumë aspekte, kishin edhe paralele në kohë e hapësirë. Kemi mërguar në kohë e hapësira të ndryshme, për arsye të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme. E kjo ka sjuar edhe përjetime të ndryshme të mërgimit si fenomen. Por disa tjera aspekte, si braktisja dhe kompensimi i gjuhës, shkëputja nga gjuha mëmë dhe konteksti social e risajimi i një surrogati të dytë, dhe gjithë ai proces gradual i kolonizimit të një bote të re, i cili vesh me një kuptim të ri jetët e migrantëve në gjithë botën. Ato ishin si të thuash tulla universale që kishim përdorur të dy për të sjuar ngrëhina jetësh paralele në këtë botë të re të çuditshme, që ngjante me botën e vjetër por edhe ndryshonte nga ajo, jo rrallë në mënyra të holla që i shmangen kapjes sikur të ishin ëndrra të mëngjesit. Dhe meqë poezia është ndjekje e së pakapshmes - poezia është ëndërr në gjendje të zgjuar thotë nobelisti Tranströmer - natyrisht që do të përdornim poezinë për të artikuluar disi këtë ëndërr të quajtur jetë.

**Poezi, prozë poetike, dialog, refleksione - nisur nga sinorë personal krejt të ndryshëm, duke u vënë përballë një fenomeni: mërgimi. Produkti letrar është: Enciklopedi e mërgimit. Ju nuk e keni quajtur poezi e mërgimit, që në një rast tjetër mund të ndodhte. E theksoj këtë, pasi shpesh konfondohej krijimi letrar me vendndodhjen, edhe pse kjo e fundit bëhet shkak, nxitës. Pse nevoja për këtë libër, nga dy emigrantë, që ndajnë të njëjtën kulturë?**

Shkëputja nga gjuha mëmë e nga kujtesa shoqërore është një traumë e heshtur. Në shqip kemi një idiomë unike, t'u harroftë emri, që ndërthen këtë traumë si namë të tmerrshme. Ne vendosëm herët se këtë vepër do ta botonim në shqip, në Shqipëri, kjo s'diskutohej. Ky vendim zbulon një nevojë të ndërlijshme për një riatdhesim



simbolik, si mënyrë për ta luftuar ndofta atë namë të lashtë. Ndonëse në fakt ishim të ndërgjegjshëm se ky riatdhesim do të ishte problematik, pse kjo qenie po riatdhesohej tash nga një atdhe i dytë. Ajo ish ngjizur në shumë plane nga ky atdhe i dytë, mërgimi, e mund të ndihej si trupi i huaj për atdheun e vjetër. Por nga ana tjetër ne nuk shkrum posaçërisht për këtë libër, por mblodhëm poezi të shkruara vitet e fundit dhe u dhamë shtëpinë e tyre të vërtetë. Universalja e temave që shtjellojmë e kishte tjerur me kohë enciklopedinë rreth tyre dhe vetëm po priste ta shihnim.

**"Enciklopedia e mërgimit", ka tërhequr vëmendjen në panairin e librit, të këtij viti, ishte një vëmendje nga lexuesit, jo e asaj natyre që mbledhin juri për të ndarë çmime? Çfarë treguesi është kjo për ju, në këto distance?**

Lexuesi dhe juritë kanë objektive të ndryshme, lexuesi do gratifikim të menjëhershëm dhe është gjithmonë në kërkim të një risie. Ndërsa juritë gjykojnë mbi jetëshkrime dhe kërkojnë të identifikojnë vlera të qëndrueshme. Fituesi i çmimit të jurisë së panairit 2019 ish-diplomati dhe autori Besnik Mustafaj është ilustrim i gjallë i kësaj, ai është penë e sigurt, autor një varg librash me poezi, prozë, e memoare. Është në natyrën e gjërave kjo, kështu ka qenë gjithmonë, ndonëse njeriu do të donte që secila instancë - si publiku, ashtu edhe juritë - të kishin ca më shumë nga virtytet e tjetrës.

Profesioni që sajón urat midis dyjave, kritika e specializuar letrare, neve thjesht na mungon; ata që shkruajnë janë shpesh po ata që bëjnë kritikë dhe kjo kuptohet se nuk është zgjidhje optimale. Ndërsa autorët migrantë si ne janë edhe të shkëputur nga rrjetëzime të natyrshme midis njerëzish të letrave në çdo vend të botës. Por në anën tjetër, sot kemi rrjetet sociale që kanë pasur një efekt demokratik edhe mbi shkrimet, një vistër autorësh migrantë janë zbuluar aty. Nga 65 autorët më të shitur sot në Kindle, vetëm 5 kanë qenë të botuar paraprakisht. Nëse botuesit dhe juritë i harrojnë migrantët, edhe ata do të harrojnë botuesit dhe juritë. Por autorët migrantë janë një fenomen që po vjen për të mbetur edhe në letërsinë shqiptare, siç po ndodh në letërsinë kudo në botë. Është fakt i gëzueshëm që publiku e çmon "Enciklopedinë e Mërgimit", çmim a pa çmim. Poezia duhet të blehet, ndryshe s'botohet më. Por ky eksperiment letrar i "Enciklopedisë së Mërgimit" do të përmendet nga kritikë të së ardhmes edhe kur të jetë harruar se në cilin vit u mbajt ky panair.

**A keni pasur një model, referenca letrare për këtë vëllim?**

Në vitin 2014 u botua një libër shumë i veçantë, Secession/Insecession, shkruar nga poetja galiciane Chus Pato dhe përkthyesja e saj në anglisht, poetja kanadeze Erin Moure, një libër që gërmon në shtresa e mbishtresa tekstesh të dy autoreve të

ndryshme që funksionojnë si palimpseste. Ato nga ana e tyre janë frymëzuar nga Octavio Paz dhe përkthyesi i tij Charles Thomlinson. Këto bashkëpunime qenë frymëzuese, por e veçanta e teksteve tona është se ne zbuluam mbasi i kemi shkruar sesa shumë plotësohen kur pranëvendosen, se derdhen në të njëjtin det.

**Është një vëllim konceptual, por në përvojën tonë letrare e para e kësaj natyre eksperimentale, një libër original, edhe në formën e një fjalori ndërkombëtar për kuptimësinë e termit emigracion. Çfarë modeli keni pasur parasysh, aq më tepër kur Shqiptari shkruan në standard, dhe ju Entela në gegnisht? Mban domethënie kjo shprehje, qoftë dhe gjuhësisht?**

Në një farë mënyre është një eksperiment që luhet në shumë nivele. Struktura e librit ndjek për shembull modelin e një enciklopedie me së pari terma të rreshtuara alfabetikisht, mandej përkufizimet si në fjalor dhe mbyllet e rrethit enciklik me njohuritë enciklopedike. Vetëm se në Enciklopedinë tonë termi bëhet titulli i një poezie dhe rrethi mbyllet në përjetimin e lexuesit. Edhe pranëvendosja e dy varianteve të shqipes është eksperimentale, por nuk është qëllim më vete, është pasojë e pranëvendosjes së teksteve të dy autorëve që shprehen në variante të ndryshme të shqipes. Kur varianti gjuhësor bëhet qëllim më vete, e ka zanat dhe bëhet më i rëndësishëm se vetë poezia. Dhe kësaj të fundit i pëlqen

me qenë zonjë mbi gjithçka.

**Po kujtoj Camajn, që në brendinë e poezisë së tij nuk ka atdhe, ka elegji, por lidhje obsesionale me "dheun", siç mund të paramendohet një poezi emigrimi. Në këtë sens poezia e tij ngre në madhësi identitetin, edhe pse i shkroi në mërgim. Pa ndroje, edhe veçmas, jo vetëm në këtë vëllim është edhe poezia juaj, edhe pse autorësia në disa mbetet në dilema...Për çfarë jeni kujdesur me tepër, në procesin e kësaj Enciklopedie?**

Camaj shkruan vazhdimisht për një atdhe të largët, në mënyra aq marramendësisht të bukura sa të ndalin frymën, ndërsa ka shumë pak për jetën e vet në atdheun e ri. Ndërsa ne nuk kemi hequr fatin e tmerrshëm të Camajt që u anatemua nga atdheu. Ne shkruajmë sh lirë edhe për jetën tjetërkund, duke mos e kategorizuar atë, duke ia lënë lexuesit të etiketojë, në qoftë se ndien nevoja të tilla. Ia kemi lënë lexuesit edhe etiketimin e autorit, nëse e ndien të nevojshme ta bëjë këtë. A është e rëndësishme për përjetimin e lexuesit ta dijë nëse një poezi e caktuar është shkruar nga burri apo nga gruaja? Sa dhe si e ngjyros leximin njohja e autorit, nëse është ai që ndoqi familjen e përndjekur apo ajo që iku e vetme me dëshirë? Këto i vendos lexuesi vetë. Ne jemi kujdesur ta lëmë të lirë rrjedhjen paralele të dy migrimeve të ndryshme nga forma, si jetësisht ashtu edhe estetikisht, por të ngjashme nga përmbajtja, siç janë përvojat njerëzore.



Entela Tabaku  
Shqiptar Oseku

## ENCIKLOPEDIA E MËRGIMIT



Onufri Puci





E jashtëzakonshme

## Ndodh e pabesueshmja, foshnja tetëmuajshe në gjyq për borxhin 13 000 euro

Një gjyq i jashtëzakonshëm po zhvillohet në qytetin gjerman të Zwickaut. Një foshnjë tetëmuajshe është në gjyq për shkak të një borxhi të trashëguar prej 13 000 eurosh. Mila trashëgoi borxhin e gjyshit të saj dhe mund të dënohet për faturat e telefonit dhe abonimin në kanalin sportiv Sky. E gjithë çështja filloi kur gjyshi i Milës, Roni, ndërroi jetë në vitin 2018 dhe nëna e saj,



Sophie Reinold, 19-vjeçare, ishte gjashtëmuajshe shtatzënë. Ajo dhe i dashuri i saj refuzuan ta paguanin borxhin e tyre pasi u thirrën në gjyq pas lindjes së vajzës. Ky vendim i tyre rezultoi me ftesë në gjyq për Milën, e cila, sipas ligjeve në fuqi, kishte trashëguar borxhin.

FOTO E DITES




Shitësit e luleve shihen duke u tërhequr nga rrënojat e një ndërtese pas një tërmeti që goditi Padadan në Filipinet jugore. /AP/

E rrallë

## Zbulimi 500-vjeçar, 'thesar' për historinë

Dy spiranca 500-vjeçare u zbuluan në bregun Gulf në Meksikë. Sipas arkeologëve, ky zbulim do të hedhë dritë mbi pushtimet e kolonialëve spanjollë në këto brigje. Ata shprehen se këto i përkisnin flotës së Hernan Cortes i cili pushtoi perandorinë Azteke në shekullin e 16. Zhytësit i gjetën ato në thellësinë 15 metra nën nivelin e



detit, poshtë një shtrese të trashë dheu. Zbuluesit deklarojnë se këto brigje janë të mbushur me 'thesar' për historinë e Spanjës.

## BARSOLETA E DITËS



- Çfarë është një parainfarkt?
- Ta futësh dorën në xhep dhe nuk e gjen celularin.
- Po infarkti?
- Kur ta merr telefonin gruaja dhe nuk i ke vënë çelës.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

## The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

**Rolet:** Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

**Regjia:** Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

## FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

**Rolet:** Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

**Regjia:** Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

## FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

**Rolet:** Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfe, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

**Regjia:** James Mangold



## Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

**Rolet:** Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

**Regjia:** Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



**DASHI**

Nuk është se keni arritur të


zgjidhni çështje që ju kanë shqetësuar këto kohë. Kjo gjë ju ka sjellë më shumë stres se zakonisht.



**DEMI**

Keni fituar pavarësi morale dhe finan-

ciare nga e shkuara juaj. Për këtë arsye jeni bërë më tolerant dhe më të hapur me të tjerët.



**BINJAKËT**

Një detaj që po ju ha shumë kohë dhe

po ju mundon sot më në fund do të gjejë zgjidhje. Ju doni të jeni i përkryer dhe do t'ia arrini qëllimit.



**GAFORRJA**

Keni filluar të keni më shumë

besim tek personat që ju rrethojnë dhe jo gjithmonë shtyheni nga instinkti për të zgjidhur një problem.



**LUANI**

Nuk keni shumë kohë për mëdyshje

dhe dyshime sot. Njerëzit tuaj të dashur do t'ju kërkojnë ndihmë dhe duhet të jeni të gatshëm pa asnjë rezervë.



**VIRGJËRËSHA**

Keni zgjedhur mënyrën më të

thjeshtë për të mos pranuar ndjenjat tuaja, duke shmangur një person të caktuar. Do të pendoheni më vonë.



**PESHORJA**

Komunikimi është shumë i rëndësishëm

sot. Nëse nuk bisedoni si me kolegët, ashtu edhe me partnerin, çështjet e mbartura nuk do të gjejnë zgjidhje.



**AKREPI**

Një person ka krijuar një ide të

gabuar për ju që nuk i korrespondon realitetit. Nëse doni të sqaroheni mund ta ftoni për një takim.



**SHIGJETARI**

Keni vënë baza të forta

për të ardhmen tuaj profesionale dhe jeni mjaft të qetë ndaj çdo ndryshimi që mund të ndodhë.



**BRICJAPI**

Duhet t'i mirëkuptoni pjesëtarët e familjes

sot që nuk do të aprovojnë një vendim tuajin që dashur pa dashur i kushtëzon edhe ata.



**UJORI**

Nuk keni zgjidhje tjetër sot përveçse

ta merrni në dorë situatën dhe të mundoheni t'i zgjidhni ngërçet e krijuara sepse mund t'ju prishin punë.



**PESHQIT**

Keni qenë shumë të

ndjeshëm ndaj ngjarjeve dhe personave që keni pasur pranë, por tashmë keni ndryshuar qëndrim nisur nga një situatë e caktuar.


## Wanda Nara: Nuk bëj seks me Mauron para ndeshjeve



**S**a herë ajo flet përbën lajm. Në një intervistë për mediet italiane Wanda Nara, bashkëshortja e Mauro Icardin, thumboi sërish Interin: "Nuk e di kush ishte ai që ia vuri syrin Mauro, por rezultoi diçka që u

leverdisi të gjithëve. Ai shkoi në një skuadër më të mirë dhe më të rëndësishme". Por, nuk mund të mungonte kjo "perlë" e modelueses argjentinase. "Mauro është profesionist, nuk bën kurrë seks para ndeshjeve", ka thënë ajo.

## Jahti 7 milionë dollarë i ish-bashkëshortit të Jennifer Lopezit shpërthen në flakë



**J**ahti luksoz i fituesit të çmimeve "Grammy", Marc Anthony, është përfshirë nga flakët në Miami. Fotografitë e publikuara nga mediat e huaja tregojnë se si zjarri ka përfshirë jahtin luksoz prej shtatë milionë dollarësh, duke e djegur atë menjëherë. Ndërkohë tymi i errët ka përfshirë të gjithë zonën, teksa forcat zjarrfikëse shihen teksa përpiqen t'i

shuajnë flakët. "Daily Mail" shkruan se zjarri ishte nën kontroll brenda dy orësh dhe se deri tani nuk ka raportime për njerëz të lënduar. Gjithashtu, mësohet se ish-bashkëshorti i Jennifer Lopezit nuk ishte në bord kur ka shpërthyer zjarri.



## Bebe Rexha ka surpriza për vitin e ri

**K**ëngëtarja shqiptare me famë botërore, Bebe Rexha, tanimë me këngët e saj që janë shndërruar thuajse në hite ka arritur të bëjë për vete një numër të madh të fansave. Ndonëse

tanimë jemi në përfundim të këtij viti, viti 2019 për të ka qenë mjaft i suksesshëm, me shumë këngë që u pëlqyen nga publiku, natyrisht se edhe me paraqitje madhështore në turneun e saj të koncerteve.

## Partnerja e CR7 në borë



**N**ë komentet e fotove të saj më të fundit ndjekësit e kanë konsideruar partneren e Cristiano Ronaldos, Georgina Rodriguez, si "mbretëreshën" e dëborës por, jo më kot. Modeluesja

25-vjeçare ka mahnitur me postimet e fundit, ku shfaqet tepër seksi, megjithëse mes të të ftohtit. Georgina ka qenë e shoqëruar nga familja, madje ka publikuar edhe video duke rrëshqitur në borë me të voglat e saj.



| <b>Autor: GAZMEND MORINA</b><br>KËNGËTARI SPANJOLL NË FOTO<br>MUZIKANTI KRASNIQI (shq.)<br>KRYENGRITËS QË DILTE MALIT E LUFTONTE PËR LIRINË E ATDHEUT<br>QË LIDHET ME ORGANIN E TË PARIT SHTET NË AZI (pashq.) |                                |                              |  |   | <b>EPOKA ERE</b><br>MBISHKRIM NË NJË GUR VARRI<br>KËNGËTARJA KANADEZE CELINE ....<br>ISMET RAMUSHI<br>SHKOP I BILARDOS<br>PËRPEKJE PËR TA VRARË NJË POLITIKAN |  |                                     |   |   |  |  |
|--|--------------------------------|------------------------------|--|---|---|--|-------------------------------------|---|---|--|--|
| ME QËLLIM, QËLLIMISHT, NERGUT  |                                |                              |  |   | KËNGËTARJA SOPJANI  |  |                                     |   |   |  |  |
| SUPER MODELJA BRITANIKE CAMPBELL   |                                |                              |  |   | KUSAR BASHKËT.  |  |                                     |   |   |  |  |
| MJET TRANSPORTI PA MOTOR, QË TËRHIQET NGA NJË AUTOMJET   |                                |                              |  |   |   |  |                                     |   | "KENIA" MJET UDHËTIMITI E TRANSPORTI (shq.)                       |  |  |
| I BUKURI (bised.)  |                                |                              |  |   |   |  | BOR, TITAN                          | KALJARI, ATALANTA "LUGANO"                        |   |  | NANTES SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË               |
| NGJITËS I XHAMAVE  |                                |                              |  |   |   |  |                                     |   | RITUAL  |  |  |
| ZANORE   |                                |                              |  |   | MBULESA ME TË CILËN DIKUSH E FSHEH FYTYRËSN   | MASHTRIM ME DIÇKA TË PAQENË LEJA PËR TË SHKUAR NGA ODA (turq.) |                                     |   |   | KËNGËTARJA ... ZARI BISKOTË E GATUAR ME ARRA OSE ME BAJAME |  |
| AXHAMI, FËMIJË I VOGËL   |                                |                              |  |   |   |  |                                     |   | RROGË VJETORE E PAPËS FUTBOLLISTI ITALIAN NESTA                   |  |  |
| <b>EPOKA ERE</b>   | ENERGJIK I SHKATHËT            | TËRËSIA E GJALLESAVE NË TOKË | QË KA TRUP TË SHËNDOSH, JETËDHËNËS                     | E GDHENDA   | <b>EPOKA ERE</b>  | LËNDË DJEGËSE E LËNGËT (shq.) ZANORE                           |                                     |   | POLITIKANI .... TOPI KAP DIÇKA TË PËJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDË  |  | APARTAMENTET   |
| KAFSHË PËR-TYPËSE TRUP-MADHE ME KËMBË TË GJATA   |                                |                              |  |   | KËNGËTARJA .... LILA "IRLANDA"  |  |                                     | DALLGA TITULL ARI-STOKRA-TËSH (shq.)              |   | ELIZABETH BANKS SIMBOL I FESË MYSLIMANE (shq.)             |  |
| JETA E QETË  |                                |                              |  |   | ENI KOÇI  |  |                                     |   |   |  | ZANORE FJALË E RËNDË DHE E PAHJSHME                            |
| MENDJEHOLLË  |                                |                              |  |   | LLOJ SHALE PREJ DRURI BASHKËT.  |  |                                     |   | LUMË NË SHQIPËRI TËRËSIA E NJERËZVE QË KANË LIDHJE GJAKU (pashq.) |  |  |
| KOHË BRENDA SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË PUNË  |                                |                              |  |   | PRODUKT I ZJARRIT MODELJA SHQIPTARE .... LLESHI   |  | MOR, HEJ (pashq.) FUTBOLLISTI MESSI |   | VDEKJEPRURËSE   |  |  |
| PJESËTAR I NJË FISI ILIR   |                                |                              |  |   | ZË I ULËT E I THELLË I FEMRAVE NË TË KËNDUAR NJOLLA   |  |                                     |   | PEMË E VENDEVE TROPIKALE ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER            |  |  |
| INDIUM   |                                |                              | LLOJ VALLËZIMI (shq.) PESHORE ME DY KRAHË TË BARABARTË |   |   |  |                                     | POLITIKANI .... NDOKA KONOP                       |   | GRIMCOVA (bised.) ZANORE                                   |  |
| VEGËL MUZIKORE   |                                |                              |  |   |   | REGJISORI .... STONE (shq.) GOJËTARI                           |                                     |   |   | ENEDA TARIFA KRAHINË E GJËRË (shq.)                        |  |
| PJESË E FORTË E BUKËS SECILA NGA DY BRINJËT E NJË TREKËNDËSHI (shq.)   | DOLLAP I VOGËL PËR ZOGJ (shq.) | ZANORE KRYEQYTETI I KANADASË |  | FUTBOLLISTI ANGLEZ .... LENON (shq.) SHKRONJË GREKE |   |  |                                     | ABSOLUTE FORCE ONLINE EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN |   | LLOJ REVOLUÇIONIT DILETANT                                 | HENDEK I THELLË E I GJËRË, QË ËSHTË HAPUR PËR TË UJITUR (shq.) |
| <b>K</b>   |                                |                              |  |   | KËNGËTARJA AMERIKANE FRANKLIN MËRI, ZILI  |  |                                     |   | ZANORE AKTORJA ARVANITASE .... PAPAS                              | ABEDIN REXHA   | BASHKËT. MARK ANTONI   |
|  |                                |                              |  |   | KËNGËTARJA KANADEZE MORISËT NËNAT   |  |                                     |   |   | KËNGËTARJA VALBONA .... ".... TAK"                         |  |
| SHPEND I EGËR ME BISHT TË GJATË (sh.shq.)  |                                |                              |  |   |   | RRALLË (Lat.) RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS                      |                                     |   |   | PJESË E EPËRME E DHOËS SHTEG                               |  |
| AUDIO VIDEO INTERLEAVE   |                                |                              |  | HYJNI E DASHURISË (mit. greke) DY BASHKËTINGËLLORE  |   |  | AKTORJA BUDAKOVA DY ZANORE          |   |   |  | ZANORE MIMOZA MUSTAFA  |
| ZAMBIA, ANGOLA   |                                |                              | VENDNISJA E NJË GARA VRAPIMI ZANORE                    |   |   |  |                                     | FUTBOLLISTI KROAT KRANJÇAR RODA                   |   |  | MITROVICA, LEZHA ZANORE  |
| FUTBOLLISTI SPANJOLL KUENKA  |                                |                              |  |   | KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA   |  |                                     |   |   | JEVGU  |  |

# Misteri i luftanijes që u fundos 20 minuta pas udhëtimit të parë

E konsideruar si luftanija më e madhe e kohës së saj, "Vasa" u përmyt brenda 20 minutave të udhëtimit të saj të parë. Gati 400 vjet më vonë, askush nuk e di pse


Kur ajo lundronte nga Gjiri i Stokholmit në vitin 1628, "Vasa" ishte luftanija më teknologjike e kohës. E ndërtuar në kohën e Mbretit Gustav II Adolf, ishte 68 metra e gjatë dhe mbante 64 topa zjarri. Kjo luftanije është një nga shembujt më të hershëm të një anijeje luftarake me dy kuverta të plota me armë.

Ditët e lavdishme të kësaj anije, të dekoruara bukur, nuk zgjatën shumë, pasi 20 minuta në udhëtimin e saj, anija u mbyt, duke vrarë 30 pasagjerë të saj.

"Vasa" qëndroi në fund të detit për rreth tre shekuj, derisa arkeologët zbuluan anijen, duke e rivendosur dhe shfaqur atë në atë që është bërë muzeu më i vizituar në të gjithë Skandinavinë.

Historia e fundosjes së shpejtë të Vasës njihet si një nga dëshimet më kolosale dhe misteret më të mëdha në historinë detare arkitekturore. Pas një erë të fortë, anija u përkul anash dhe filloi të mbushej me ujë përmes porteve të hapura të topave. Ajo u përmyt në udhëtimin e parë duke e bërë publikisht "Vasan" si një katastrofë kombëtare. Pas fundosjes së papritur, një kërkim përcaktoi që anija ishte e paqëndrueshme, e arsyet e paqëndrueshmërisë ende po diskutohen sot.

Disa historianë besojnë se anija ishte projektuar gabimisht, të tjerë arsyetojnë se pesha e fuqisë së zjarrit të anijes ishte shpërndarë në mënyrë jo të duhur. Por, ndërsa anija ishte zhytur para gati 300 vjetësh, në



një farë mënyre arriti të mbetet e ruajtur mrekullisht.

Kur u ndërtua, "Vasa" ishte zbukuruar me gdhendje të ndërlikuara prej druri që tregonin histori për familjen mbretërore suedeze. Për shkak të ujit të ftohtë, të varfër me oksigjen të Detit Baltik, anija u mbrojt nga bakteret dhe krim-

bat që zakonisht tretin mbetjet prej druri. Kur u tërhoq nga gjiri në vitin 1961, ekspertët vlerësuan se 98 për qind e drurit original të anijes ishte akoma i paprekur, duke e bërë atë anijen më të ruajtur në botë të shekullit XVII. Tani anija, e cila ndodhet në Muzeun Vasa të Stokholmit, është në rrezik të

ketë përsëri "fatin e keq". Brenda mureve të muzeut, anija ka filluar të "përkulet anash", rreth një milimetër në vit drejt tokës. Por, ekspertët nuk do të lejojnë që historia të përsëritet – anija po pëson riparime për të siguruar që ajo do të ruhet për brezat e ardhshëm. // *Telegrafi*

## Dalin për herë të parë telegramet e Petro Markos nga burgu

Studiuesja Jorina Kryeziu Shkreta rrëfen takimin me të bijën e Petro Markos, Arianitën, e cila e ka ndihmuar për hulumtimet mbi ditarin e Petro Markos, por edhe mbi telegramet e burgut. Nga shënimet e intelektualëve në burg, studiuesja veçon ditarin e Petro Markos, jo për realitetin që përshkruante, por sepse i kushtohej dashurisë. Përpos ditarit nuk mungojnë as telegramet me familjarët, për të cilat Kryeziu pohon se dalin për herë të parë.

"Vajza e tij, Arianita më mirëpriti edhe përveçse më disponoi ditarin, për herë të parë më dha edhe telegramet. Petro Markon tashmë do ta njihni me letërkëmbimet që ka kryer në burgun e Armiqve të Popullit në Tiranë. Përpos ditarit, ai mban edhe letërkëmbime me Safolinën, Arianitën të bijën, të vëllanë e të shoqes. Këto telegrame kanë interes, sepse tregojnë kohën edhe vuajtjet e tij, edhe pse ai kërkon që t'i injorojë vuajtjet fizike në qëndrimin brenda qelisë, duke u fokusuar tek dashuria. Nuk janë letërkëmbime të rregullta, por janë letërkëmbime për ftesa kombëtare edhe raste të veçanta. Të gjitha telegramet pas nënshkrimit mbajnë firmën e



drejtuesit ku ai vuante dënimin", rrëfen Kryeziu.

Ditarin, por edhe telegramet e burgut, studiuesja i vlerëson si pjesë të pandarë të letërsisë dokumentare. Tre vite burgim ku tregohet brutaliteti i sistemit,

ashpërsia me intelektualët, që quheshin "Armiqtë e Popullit".

"Nëpërmjet këtij ditari vjen bota e tij e madhe, jo në statusin e të burgosurit, por të shkrimtarit. Janë shkrime që ai e shndërron realitetin në art. Anën e errët të

jetës edhe dritën vezulluese brenda mureve të qelisë ai i shikonte tek forca e dashurisë. Nëse të tjerët vuajnë mungesën e lirisë brenda hekurave, ai e gjen lirinë përmes forcës së dashurisë. Mendon se është pikërisht forca e


dashurisë që e mbajti gjallë", shprehet studiuesja.

Studiuesja përfundon se në rastin e Petro Markos jeta edhe vepra janë një, prandaj botimi i tyre do të ishte zgjedhja e duhur.

/Report TV/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Envert

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Ramadani: Kalimi në fazën e dytë, synimi i Kosovës

"Kemi një synim në Itali, të kalojmë në fazën e dytë. Kemi ekip cilësor që gjithnjë është në ngritje. Më nuk duhet të kënaqemi vetëm me paraqitje dinjitoze. Duhet të jemi ambiciozë, të luftojmë të barabartë me çdo ekip dhe të besojmë në aftësitë tona", ka thënë Taip Ramadani, përzgjedhës i Kosovës në hendboll



## "Epoka e re"

**PRISHTINË, 19 DHJETOR** - Përzgjedhësi i Kosovës në hendboll, Taip Ramadani, ka thënë se është shumë i kënaqur me konkurrencën në ekipin përfaqësues të "dardanëve". Numri një i shtabit teknik e ka pranuar se ka pasur vështirësi për ta përzgjedhur ekipin për shkak të konkurrencës së madhe. "Seleksionimi i këtij ekipi ka qenë ndër më të vështirët që kemi bërë vitet e fundit. Ka konkurrencë të madhe në të gjitha pozitat dhe jam shumë i kënaqur që kam filluar të ndiej një vullnet të lartë në mesin e lojtarëve për ta përfaqësuar shtetin tonë. Po e vërej një rrymë të re dhe shpresoj ta shprehim këtë energji në fushë të hendbollit", ka thënë Ramadani. Në radhët e Kosovës tre hendbollistë do ta bëjnë debutimin. Lidhur

me këtë përzgjedhësi Ramadani ka deklaruar: "Në këtë grumbullim kemi ftuar për herë të parë Liridon Zenën që e kemi përcjellë për tre vjet. Është portier që me vite aktivizohet në Kroaci, kurse po ka një stinor të shkëlqyeshëm me klubin e tij. Për herë të parë në ekipin A na bashkohet Albin Xhafolli, që mori pjesë në Kampionatin Botëror për Juniorë në Spanjë dhe më ka lënë mbresa të mira si teknik i shkëlqyeshëm. Kemi ftuar në këtë grumbullim edhe Leonard Gegajn. 18-vjeçari është një lojtar i së ardhmes. Është pjesë e Savehofit në Suedi ku luan edhe Gëzim Salih. Leonardi verën e kaluar ishte në Prishtinë dhe pata rastin ta shoh në stërvitje. Menjëherë më la përshtypje. Ka shpejtësi, forcë eksplozive dhe inteligjencë të jashtëzakonshme për moshën e tij. Kemi ftuar disa lojtarë të rinj dhe jam i bindur se u

ka ardhur koha të marrin përgjegjësi më të madhe dhe ta fillojnë udhëtimin në elitën ndërkombëtare të hendbollit". "Dardanët" janë në grupin e tretë së bashku me Italinë, Rumaninë dhe Gjeorgjinë, kurse përzgjedhësi Taip Ramadani ka thënë se synimi i Kosovës në kualifikimet për Kampionatin Botëror të vitit 2021 është kalimi i një raundi. "Kemi një synim në Itali, të kalojmë në fazën e dytë. Kemi ekip cilësor që gjithnjë është në ngritje. Më nuk duhet të kënaqemi vetëm me paraqitje dinjitoze. Duhet të jemi ambiciozë, të luftojmë të barabartë me çdo ekip dhe të besojmë në aftësitë tona", ka thënë Ramadani. Më 10 janar Kosova luan me Italinë, më 11 janar me Rumaninë, kurse më 12 janar me Gjeorgjinë. Fituesi i grupit avancoi në raundin tjetër, kurse ndeshjet luhen në Benevento të Italisë.

## SHKURT

### Shqipëria dhe Kosova nuk ndryshojnë në renditjen e FIFA-s

Shqipëria dhe Kosova nuk kanë ndryshuar pozicionin sa i përket renditjes mujore të FIFA-s që është bërë publike ditën e sotme. Kështu, kombëtarja kuqezi vazhdon të ndodhet në vendin e 66, duke pasur mbi vete Slloveninë, ndërsa ndiqet nga Arabia Saudite. Edhe Kosova nuk ka ndryshuar pozicionin dhe ndodhet në vendin 115. "Dardanët" janë poshtë Azerbajxhanit dhe ndiqen nga Koreja e Veriut. Ndërkaq as 10-shja e parë nuk ka ndryshuar, duke qenë se kombëtalet nuk kanë zhvilluar asnjë ndeshje gjatë këtij muaji, teksa Belgjika kryeson në vendin e parë, e ndjekur nga Franca dhe Brazili.

### Feronikeli rikthen nga huazimi dyshe Balde-Andrews

Skuadra e Feronikelit ka rikthyer në radhët e veta dyshe e huazuar te skuadra e Drenicës: Prince Balde dhe Nicholas Andrews. "Prince Balde shkëlqeu te KF Drenica në pozitën e qendërmbrojtësit, duke bërë që të kërkohet rikthimi i tij te FC Feronikeli. Në anën tjetër, Nicholas Andrews, një qendërsulmues tejet i shpejtë, është i aftë të depërtojë shumë mirë në situata një me një. Që të dy përforcojnë edhe më shumë klubin tonë dhe si klub jemi tejet të lumtur që i kemi rikthyer në skuadër", thuhet në njoftimin e Feronikelit.

### Broja, 9 gola në 9 ndeshje për Chelsean

Sulmuesi shqiptar Armando Broja vazhdon të shkëlqejë te të rinjtë e Chelseat. Broja ishte protagonist kryesor në fitoren 4-0 të 18-vjeçarëve të Chelseat ndaj Huddersfield Town, duke realizuar 3 gola në këtë sfidë të vlefshme për FA Youth Cup. Ky sezon ka nisur në mënyrë të shkëlqyer për Brojën, i cili në 9 takime ka realizuar po kaq gola me skuadrën e 18-vjeçarëve, ndërsa ka realizuar edhe një gol me ekipin e dytë të Chelseat.

### Shaqiri refuzon Galatasarayn

Xherdan Shaqiri është i vendosur të qëndrojë te skuadra e Liverpoolit, prandaj e ka refuzuar huazimin në skuadrën e Galatasarayt. Klubet kishin arritur marrëveshje për kalimin e Shaqirit në skuadrën turke në formë huazimi, por anësori shqiptar refuzoi një gjë të tillë. "Shaqiri ka refuzuar huazimin te Galatasaray, pasi dëshiron të mbetet te Liverpooli. Galatasaray kishte arritur marrëveshje me Liverpoolin për huazimin e tij, me detyrim të blerjes në fund të këtij edicioni, por Shaqiri prishi planet e Galatasarayt", ka shkruar "Sozcu Gazetesi". 27-vjeçari këtë edicion ka tetë paraqitje dhe një gol në të gjitha garat me Liverpoolin, ekip me të cilin ka kontratë deri në vitin 2023.

### Demiri ndahet me Dukagjinin

Dukagjini i Klinës ka nisur ndryshimet në skuadër, pas një stinori jo të mirë në Superligë. Me marrëveshje me klubin është larguar një prej transferimeve të verës, Husein Demiri. "Prej janarit nuk jam më pjesë e Dukagjinit të Klinës. Ne jemi ndarë me marrëveshje të dyanshme. Pse u largova? Nuk ka ndonjë arsye specifike, thjesht i erdhi fundi", ka thënë Demiri për "Olle". "Kam disa oferta nga Superliga e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë. Do t'i shqyrtoj shumë mirë dhe më pas do të vendosi", ka deklaruar Demiri.

## Liverpool - Flamengo, finalja e Botërorit të Klubeve

DOHA, 19 DHJETOR - Liverpooli do të diskutojë me Flamengo për trofeun e Botërorit të Klubeve që po zhvillohet në Katar. Skuadra e Jürgen Kloppit eliminoi në

gjysmëfinale meksikanët e Monterrey duke i mundur 2-1 në një sfidë që nuk ishte aspak e lehtë për kampionët e Evropës. Skuadra meksikane duket se i kishte

marrë mirë masat për këtë përballje dhe e rrezikoi jo pak herë Liverpoolin që në fund diti ta marrë maksimumin dhe të kalojë në finale. Më 21 dhjetor "Reds"

do të përballen me kampionët e Amerikës Latine, Flamengo për titullin botëror për klube një titull që i mungon skuadrës së Liverpoolit.



## Sot dhe nesër xhiroja e fundit në basketboll

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Sot (e premte) dhe nesër (e shtunë) do të zhvillohen ndeshjet e javës së 18 apo xhiroja e fundit e stinorit vjeshtor në Superligën e Kosovës në basketboll. Takimi i parë do të zhvillohet ndërmjet Trepçës dhe Lipjanit, ku mitrovicasit do ta kërkojnë fitoren e dytë radhazi, pas asaj ndaj Feronikelit. 'Xehetarët' kanë tri fitore dhe 12 humbje, kurse lipjanasit kanë 15 humbje në po aq ndeshje të zhvilluara. Përballje shumë interesante pritet të zhvillo-



het ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Sigal Prishtinës. Prishtinasit janë liderë me 12 fitore dhe tri humbje, kurse therandasit ndodhen në vendin e katërt me 10 fitore dhe pesë humbje. Ky takim pritet të jetë shumë interesant, duke marrë parasysh se dy skuadrat kanë treguar lojërë shumë të mira në këtë kampionat. Të shtunën Bashkimi do të sfidohet nga Feronikeli. Prizrenasit kanë 11 fitore dhe katër humbje, kurse

skuadra nga Drenasi ka katër fitore dhe 11 humbje. Sfida e fundit sjell edhe superderbin ndërmjet Rahovecit dhe Pejës, që shënon edhe mbylljen e stinorit vjeshtor. Vreshtarët kanë 11 fitore dhe katër humbje, kurse verdhezinjtë tetë fitore dhe shtatë humbje. Këto dy skuadra janë ballafaquar edhe në Ligën Ballkanike, duke dhuruar ndeshje të bukura dhe kështu pritet të jetë edhe të shtunën mbrëma në palestrën "Mizair Isma".


### SUPERLIGA

Të premten takohen:  
17:00 Trepça - Lipjani  
19:00 Golden Eagle Ylli - Sigal Prishtina

Të shtunën takohen:  
17:00 Bashkimi - Feronikeli  
19:00 Rahoveci - Peja

## Fitojnë Cavaliers dhe Toronto, Golden State në krizë

Detroit, 19 dhjetor - Cleveland Cavaliersi arriti një fitore "in-extremis" në "Quicken Loans Arena" përballë Charlotte Hornetsit 100-98, pavarësisht formës së jashtëzakonshme të Terry Rozierit, autor i 35 pikëve për mysafirët. Morën më shumë vlerë në këtë përballje 23 pikët e Collin Sextonit dhe "double double" të Kevin Loves e Tristan Thompsonit. Ndërkohë, kampioni në fuqi i NBA-s, Toronto Raptors, fitoi 99-112 në parketin e Detroit Pistonsit, me "triple double" të Kyle Lowryt (20 pikë, 10 asistime dhe 10 rikuperime), ndërsa Pascal Siakam shtoi 26 pikë. 25 pikë e 13 "rebounde" realizoi edhe Serge Ibaka. Nuk shërbeu për asgjë paraqitja e Andre Drummondit, autor i 22 pikëve dhe 18 rikuperimeve. Një kosh i shënuar 9 sekonda para rënies së sirenës nga Wendell Carter Jr. ia dhuroi suksesin me vetëm një pikë diferencë 109-110 Chicago Bullsit në transfertë me Washington Wizardsin. Lauri Markkanen spikati me 31 pikë, ndërsa Zach LaVine shtoi 24 pikë të tjera për Bullsit. Në radhët e Wizards Davis Bertansi realizoi 26 pikë, me Bradley Beal që shtoi edhe 22 të tjera, raporton



### Rezultatet

|                               |         |
|-------------------------------|---------|
| Cleveland C. - Charlotte H.   | 100-98  |
| Detroit P. - Toronto R.       | 99-112  |
| Washington W. - Chicago B.    | 109-110 |
| Philadelphia 76ers - Miami H. | 104-108 |
| Minnesota T. - New Orleans P. | 99-107  |
| Oklahoma C. - Memphis G.      | 126-122 |
| Denver N. - Orlando M.        | 113-104 |
| Dallas M. - Boston C.         | 103-109 |
| Portland T. - Golden State W. | 122-112 |

"Supersport". Surpriza e mbrëmjes ishte pa dyshim humbja e Philadelphia 76ers përballë Miami Heat 104-108, pavarësisht "double double" (22 pikë e 19 "rebounde") të Joel Embiid. Spikati loja në grup e 76ers, me 5

lojtarë me shifra të dyfishta pikësh, kryesuar nga Kendrick Nunn (26) e Bam Adebayo (23). New Orleans Pelicansi triumfoi në shtëpinë e Minnesota Timberwolvesit me rezultatin 99-107 falë 34 pikëve të Brandon Ingram, ndërsa 27 pikët e Andrew Wigginsit nuk i shërbyen për asgjë Minnesotas. Oklahoma City Thunder ndërkohë iu imponua 126-122 Memphis Grizzliesit, me protagonist kryesor gjermanin Dennis Schroder, më i miri mbi parket me 31 pikë. Në radhët e Grizzliesit shënoi 27 pikë Brandon Clarke dhe 24 Jonas Valanciunas.

### SHKURT

#### Një femër shkruan historinë në botërorin e 'Dart'

Britanikja Fallon Sherrock është femra e parë që arrin të fitojë një ndeshje në garat e Kampionatit Botëror të Gjuajtjes në Shenjë (Dart), ngjarje që po zhvillohet në Londër (Angli). Në raundin e parë ajo mundi 3-2 me përmbysje britanikun Ted Evetts. Sherrock ishte në disavantazh 1-2, por arriti të rikuperojë dhe fitojë, duke avancuar në raundin e dytë. Ajo është femra e parë që arrin të fitojë në një botëror të "Dart", duke shkruar historinë. "Tregova se ne mund të luajmë njësoj si meshkujt dhe mund t'i imponojmë ata", ka thënë sportistja 25-vjeçare, një nga 5 femrat pjesëmarrëse në këtë botëror të gjuajtjes në shenjë.

#### Valverde e pranon: Reali na bëri të vuajmë

Trajneri i Barcelonës, Ernesto Valverde, e ka vlerësuar lart paraqitjen e Real Madridit në barazimin pa gola në "Camp Nou". "Është normale që kemi vuajtur. Ajo është një skuadër e madhe. Gjëja më normale është se Reali luftoi deri në fund dhe jo ajo që ne kemi vënë pesë mbrojtës mbrapa", ka thënë Valverde. "Ata zhvilluan një presion të lartë në pjesën tonë, por ne krijuam lojën tonë dhe dolëm në disa raste para golit të tyre, por nuk arritëm të shënonim", ka shtuar Valverde.

#### Arteta do të jetë trajneri i Arsenalit

Ish-mesfushori spanjoll Mikel Arteta do ta nisë zëjën e trajnerit tek Arsenal, fanellën e së cilës skuadër e ka veshur për pesë sezone në të kaluarën. Gazetari i njohur Fabrizio Romano ka konfirmuar se emërimi i Mikel Artetas si trajner i Arsenalit është punë e kryer. Sipas tij, tani është duke u mbyllur marrëveshja. "Mikel Arteta tek Arsenal, koha për t'i rregulluar letrat. Plotësisht e konfirmuar. Këtu shkojmë", ka shkruar Romano.

#### Zidane: Meritum më shumë se një barazim

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, ka thënë se barazimi pa gola në mes të Real dhe Barcelonës në "El Clasico" nuk ishte i mjaftueshëm për skuadrën e tij. Hera e fundit që Barça dhe Reali luajtën baras pa gola në La Liga ishte 23 nëntori i vitit 2002 në "Camp Nou". "Rezultati nuk është mjaftueshëm i mirë për mua. Kemi mundur të bëjmë më shumë, por kështu e ka futbollin. Kur ke shanse, duhet t'i shënosh, pikërisht kjo po na mungon në raste të taktuara", ka thënë Zidane.

#### Joshua e mbështet Furyt: Besoju instinktit tënd

Anthony Joshua e ka mbështetur vendimin e Tyson Furyt për ta zëvendësuar trajnerin e vet, duke thënë se rivali i tij duhet patjetër t'i besojë instinktit të vet. Joshua mbeti i përkushtuar me besimin për të vazhduar me trajnerin Rob McCracken, por Fury zgjodhi t'i ndajë rrugët me trajnerin Ben Davison dhe e zëvendësoi atë me Sugarhill Steward. Fury barazoi në meçin e parë me Deontay Wilder nën udhëheqjen e Davisonit, por tani do të përgatitet për rimeçin e shkurtit për WBC me trajnerin e ri Steward. Joshua vendosi ta mbajë trajnerin McCracken edhe pasi humbi ndaj Andy Ruiz Jr dhe besimi në të iu shpague pasi e mundi boksierin meksikan në rimeçin e këtij muaji. Por duke folur për vendimin e Furyt, Joshua tha për Sky Sports: "Fury duhet ta bëjë atë që është e drejtë për të. Suksesi i Tysonit është suksesi i Benit. Nëse Fury ndien se kjo është gjëja e duhur për të, atëherë ai duhet t'i besojë instinktit të tij. Edhe unë duhet t'i besoj instinktit tim".

RESTAURANT

---



**SWISS**

TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË







## Gjej PUNË



- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





[www.facebook.com/gjeipuneshpeite](http://www.facebook.com/gjeipuneshpeite)

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ( SHSKUK )  
 Univerzitetska Bolnica I Klinicka Sluzba Kosova ( UBKSK )  
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo ( HUCSK )  
 Spitali Përgjithshëm Ferizaj( SPF ) - Opsta Bolnica Uroševac(OBU) - Hospital General Ferizaj (HGF )

---

Drejtoria e spitalit përgjithshëm të Ferizajt, bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dhe neni 4 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neni 5 i Rregullores Nr.1003/2016 mbi marrëdhënien e Punës të SHSKUK-së, si dhe aprovimin elektronik e dt.06.09.2019 nga drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK. Me datë 05.12.2019 shpallë këtë:

**NJOFTIM**

Njoftohen të gjithë Kandidatët Mjekë – specialistët e interesuar se Konkursi i shpallur më datën 05.12.2019 për poziten:

- Specialist Oftalmolog, një (1) pozitë

me numër të referencës 922/19 në Gazetën ditore „ Epoka e Re ”, vazhdohet edhe për pesëmbdhjetë (15) ditë kalendarik, nga data: 05.12.2019 deri më datën 19.12.2019

Të gjithë Kandidatët të cilët kanë aplikuar në afat dhe procedure të rregull, nuk kanë nevojë për ri-aplikim.

Drejtor Ekzekutiv  
 Dr.Jeton Zeqiri

---


Imenik Opšte bolnice u Uroševcu, na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03 / L-212 i člana 4,6 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o uređivanju postupaka za takmičenje u javnom sektoru, kao i člana 5 Uredbe br. 1003/2016 o radnim odnosima HUCSK-a, kao i elektronskog odobrenja od 06.09.2019 od strane generalnog direktora HUCSK-a. Dana 05.12.2019. Donosi sledeće:

**PRESS**

Svi kandidati za medicinu - specijalisti zainteresovani za konkurs objavljen 05.12.2019 za pozicije:

Ur, specijalista Oftalmologa, jedan ( 1 )  
 sa referentnim brojem 922/19 u dnevnom listu "Epoka e Re", nastavljeno petnaest (15) kalendarskih dana, od: 05.12.2019 do 19.12.2019  
 Svi kandidati koji su se prijavili pravovremeno i na postupak, ne moraju se ponovo prijavljivati.

Izvršni direktor  
 Dr Jeton Zeqiri



# AUTOSHKOLLA

## “RITMO – L”

**Auto Shkolla**  
**“RITMO - L”**  
**Prishtinë**

**Eksperienca jonë**  
**- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:**  
**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**  
**044 248 173**  
**044 200 604**  
**044 375 333**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology*

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë duke u bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 14/2017 të datës 06.12.2017 dhe vendimin e Ministrit nr. 197/01B dt.11.12.2019:

**SHPALL**  
**KONKURS**

PËR NDARJE TË BURSIVE PËR STUDENTËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR PËR UNIVERSITETET PUBLIKE TË NIVELEVE: BAÇELOR DHE MASTER PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020

**Kushtet dhe kriteret**

- Për fitimin e bursës së MASHT, kandidatët duhet ti plotësojnë këto kushte dhe kriteret bazë:
  - Të jenë student të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës;
  - Të jenë në kategorinë e studentëve me aftësi të kufizuara;
  - Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.

**Dokumentacioni që kërkohet për të gjithë studentët:**

- Formulari i aplikacionit nga MASHT, i cili mund të shkarkohet në linkun e MASHT-  
<https://masht.rks-gov.net/>, për bursë drejtuar MASHT;
- Certifikata e lindjes origjinale;
- Vërtetimi i statusit të studentit për vitin akademik 2019-2020;
- Vërtetimi nga organet kompetente që studenti është me aftësi të kufizuara (origjinal)
- Certifikata e vërtetuar e notave nga fakulteti për dy nivelet e studimit (BA dhe MA);
- Kopja e letërnjoftimit;
- Konfirmim nga banka për xhironlogarinë bankare, e cila llogari duhet të jetë aktive. Llogaria bankare duhet të jetë e vet studentit që aplikon;
- Të gjitha dokumentet që kërkohen me UA. 14/2017, duhet të jenë origjinale dhe të lëshuara nga organet kompetente.

**Procedurat e aplikimit**

- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit bëhet në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, rr. "Agim Ramadani" p. n. 10000, Prishtinë, kati i III, nr. 301.
- Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni.
- Dokumentet e dorëzuara mbesin dosje të arkivuara në MASHT dhe nuk mund të kthehen.
- Lista e studentëve përfitues do të bëhet publike në uebfaqen e MASHT.

**Konkursi do të jetë i hapur 4 ditë nga data e shpalljes së konkursit.**

Dokumentet e dorëzuara të studentëve me aftësi të kufizuara, sipas konkursit paraprak të datës 28 tetor 2019, janë valide edhe për këtë konkurs, ndërsa të gjithë studentët tjerë me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë aplikuar, kanë afat aplikimi 4 ditor, pra deri më datë 23 dhjetor 2019, në ora 12:00.

Aplikimi mund të bëhet edhe në mënyrë elektronike (dokumentet e skanuara), në këto email adresa edhe gjatë fundjavës:  
[Burim.gashi@rks-gov.net](mailto:Burim.gashi@rks-gov.net)  
[Shpresa.mehmeti@rks-gov.net](mailto:Shpresa.mehmeti@rks-gov.net)

**E drejta e ankesës:** Kandidatët që kanë aplikuar për përfitim të bursës, kanë të drejtë ankese në afat prej 3 (tri) ditësh, pas shpalljes së rezultateve. Ankesat dorëzohen në arkivin e MASHT, kati përdhës, zyra nr. 4 dhe shqyrtohen nga Komisioni për ankesa dhe parashtrësia i MASHT.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- DPT "Bruti Trading - Co" shpall të pavlefshme certifikatën e numrit fiscal: 600204995, Prizren.
- Negipe Haziri shpall të pavlefshme licencën e punës formati i mall Ko- 04875-01 Prizren
- Kreshnik Kadriu, shpall të pavlefshme Diplomen e SHMGJ. "Hamez Jashari" Skenderaj.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

**Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.**

**Fata Hoti, shpall të pavlefshme Certifikatën e biznesit individual me nr. 71258319. Skenderaj**